ExLibris

ISSN 2708-4876

E PËRJAVSHME LETRARE KULTURORE

Themelues • Kryeredaktor BUJAR HUDHRI

E SHTUNË, 19 QERSHOR 2021. NUMËR 135 VITI IV I BOTIMIT. ÇMIMI 50 LEKË. WWW.EXLIBRIS.AL EMAIL: INFO@EXLIBRIS.AL BOTIM I ONUFRI SHPK

Me rastin e përkthimit të *Rimave* nga Zef Skiro di Maxho

TAKIMI "I PASHMANGSHËM" I SHQIPTARËVE ME DANTEN

Nga Matteo Mandalà

Zef Skiro dëshmon një profil të lartë traduktologjik edhe me disa zgjidhje "të pazakonta" që vihen re, për shembull, në përdorimin e sicilianizmave tashmë të konsoliduar në arbërishten e folur, të cilat, përtej konsideratave mirëfilli sociolinguistike dhe dialektologjike, i kishte përdorur edhe vetë Dantja.

DITË LEXIMESH NË PARKUN E MADH TË LIQENIT

Nga Xhevair Lleshi

SHËNIME PËR LIBRAT

Mrekullia surrealiste te "Vera pa kthim" e Besnik Mustafaj

Prof.ass.dr.Maklena Nika (fq.4)

Rreth tregimit "KULLA" të Anton Pashkut

Vetëdija mitike e qenësisë dhe e qëndresës

Nga Anton Nikë Berisha (fq.6)

Prend Buzhala: "Psherëtima pergamene"

ARTI QË SHENJTËRON

Nga Sarë Gjergji (fq.11)

Botim i ri nga Ombra GVG

TAO TE CHING

RRUGA DREJT VIRTYTIT

Narrativa në romanin "Bretkosat" të Mo Yan

nga Eranda Allmetaj (PhD) (fq. 19)

ATË ALI TOMORI NAIM FRASHËRIT

nga Mehmet Gëzhilli (fq. 12)



Poezia e Vehbi Skënderit, botëvështrim nëpërmjet bukurive njerëzore

Nga Skënder Buçpapaj (fq. 8)

"Poeti e shikon botën ashtu si burri e shikon gruan." Rrallëkujt mund t'i shkojë sa Vehbi Skënderit dhe poezisë së tij ky përcaktim i poetit amerikan të shekullit të kaluar Wallace Stevens.

Tatjana Tolstaja

Në kujtim të Brodskit

(fq.20)

BILL CLINTON:

'Kam dashur gjithmonë të bëhem shkrimtar, por dyshoja në aftësinë time

Nga The Guardian (fq.22)

BIBLIOTEKË

Ahmet Selmani (fq. 14)
Duke mos e pritur godonë

Andreas Dushi (fq. 15)
Puthja e tretë që mund të futet në roman

Nurie Emrullai (fq. 16)
Lidhur pas hëne

Samanta Schweblin (fq. 23)
Rrëmihësi

SUPERMENI, HERKULI DHE BINDËSIT E OPINIONIT

Nga Pol Milo

ZUZANA FINGER:

Letërsia bashkëkohore e vendeve shqipfolëse është cilësore

Bisedoi Ledio Hala

Me rastin e përkthimit të *Rimave* nga Zef Skiro di Maxho

TAKIMI "I PASHMANGSHËM" I SHQIPTARËVE ME DANTEN

Nga Matteo Mandalà

Në titullin e një eseje të famshme Ismail Kadare e ka quajtur *të pashmangshëm* takimin me Danten. Një cilësim i fortë që meriton dy konsiderata të shpejta: nga njëra anë, gjithë duke përligjur lidhjet ndërtekstore mes veprës narrative të shkrimtarit të madh shqiptar dhe udhëtimit në botën e përtejme të kryepoetit tonë, ai cilësim hedh dritë në mënyrë epifanike mbi natyrën e raportit të veçantë mes një Populli, atij shqiptar, dhe një Poeti, italianit *ante litteram*, që e lidhi emrin e vet me universalitetin e poezisë. Nga ana tjetër, nuk është e rastit që pikërisht duke ekzaltuar fuqinë e paktit intim, të fshehtë, të thellë, pra të pashmangshëm, që shqiptarët kanë lidhur me Poetin Hyjnor, Kadare i vuri vetes detyrën të kërkonte nëpër skutat e historisë së trazuar shqiptare domethënien e vërtetë të karakterit të pashmangshëm të takimit me Danten a më mirë të themi të takimit mes dy popujve dhe dy kulturave që shkrimtari shqiptar qëllimisht e daton duke filluar nga pushtimi italian i Shqipërisë. Në faqet e esesë përshkruhen ngjarje të cilat jo vetëm e ndajnë nga pushtimi fashist i 7 prillit 1939 vëmendjen që shqiptarët i kushtuan veprës së Dantes, por na japin disa çelësa leximi të cilët po mjaftohemi vetëm t'i cekim shkarazi, sepse nuk është vendi këtu për t'i shtjelluar hollësisht.

Në thelbin e vet "poetik" hipoteza e Kadaresë mbetet e vlefshme: karakteri i "pashmangshmërisë" së Dantes nuk mund të shpjegohet ndryshe veçse duke e lidhur me periudhat e ndryshme historike dhe me kërkimin e dëshpëruar nëpër vargjet danteske të rrugëdaljes nga krizat epokale që kanë jetuar shqiptarët. Po ashtu, s'ka dyshim fakti që Kadare nuk mënon të vërë në dukje se historia e takimit të këtyre të fundit me veprën e Dantes nis nga kohëra shumë më të vjetra dhe sidomos se protagonistët e parë të asaj historie kanë qenë ata shqiptarë të cilët qysh nga Mesjeta e Vonë, pra duke nisur nga dhjetëvjeçarët që pasuan vdekjen e Dantes, u ra shorti të mërgojnë përgjithmonë në Itali. Po të marrim parasysh disa të dhëna të jashtme nga jeta e dy studiuesve arbëreshë të Dantes – Domenico Mauro (1812-1873) dhe Tommaso Di Salvo, i pari nga Shën Mitri në Kalabri, i dyti nga Hora e Arbëreshëve në Sicili – mund të rindërtojmë kufijtë gjeografikë dhe kronologjikë që përcaktojnë, nga njëra anë, vendet arbëreshe ku është rrënjosur kulti i Dantes, nga ana tjetër, periudhën historike gjatë së cilës janë realizuar kontributet më të mira në studimin dhe përkthimin e veprës së Dantes. Kësisoj mund të kuptojmë më mirë arsyet që e bënë Kadarenë ta quante "të pashmangshëm" takimin me Poetin e Madh, duke përdorur po atë mbiemër që zakonisht përdorim për fatin e njerëzve dhe të komuniteteve.

Një nga këto arsye ngjan me një magji sa të brishtë aq edhe të fortë, sikurse magjia që ngjall fjala poetike danteske anë e mbarë botës. Ndoshta kemi të drejtë të supozojmë se arbëreshët janë magjepsur nga profecia e Cacciaguida-s dhe mund të kenë gjetur aty shëmbëllimin e andrallave të tyre të vjetra, të endjeve të gjata dhe të fatit dramatik të mërgimtarëve. Ndoshta, duke e vënë veten në vend të Dantes përpara detyrimit të për braktisur *çdo gjë të dashur*, sidomos Atdheun, të pajisur edhe ata me *frymën e shenjtë*, do të kishin bërë gjithçka për të shmangur vuajtjet për shkak "të bëmave të tyre". Ndoshta kësaj i detyrohet përpjekja e tyre për të shndërruar *bujtinën e dhimbjes* në një vatër të re, një përpjekje e vazhdueshme sidomos në çastet në tragjike të historisë italiane, fillimisht gjatë Risorxhimentos, pastaj gjatë dy luftërave botërore, por edhe më vonë, gjatë periudhës së rindërtimit që pasoi. Tek e fundit, pikërisht Italia që ëndërrohej më kot nga Dante, ishte vendi për të cilin luftuan arbëreshët dhe po ajo Itali përbënte një vegim për shqiptarët që nga Ballkani hidhnin vështrimin me admirim dhe nderim përtej Adriatikut, me shpresën se do të mund të shihnin të realizuar ëndrrën për të pasur edhe ata një Atdhe të lirë e të pavarur. Te ky ideal i përbashkët, që thuajse përbën një marrëveshje "kombëtare" në emër të Poetit Hyjnor, takohen shqiptarët e Veriut, të cilët përkthyen të parët gegërisht veprën e Dantes, me arbëreshët që ia hynë përkthimit të asaj vepre në variantin e tyre dialektor të toskërishtes.

Sfida për të përkthyer veprën danteske ka qenë e vështirë, edhe sepse atyre nuk u shpëtonte domethënia e fjalëve që vetë Dantja kishte shkruar te *Convivio*:

"Nulla cosa per legame musaico armonizzata si può de la sua loquela in altra trasmutare senza rompere tutta la sua dolcezza o armonia" (*Convivio*, I, 7).

Arti i përkthimit është i ndërlikuar dhe jo gjithmonë të lejon të arrish rezultate të larta. Këtu qëndron, me gjasa, shpjegimi i përpjekjeve të ndryshme, të gjitha të lavdërueshme, duke filluar fundi i shekullit XIX deri më sot për t'u dhënë përkthimeve "harmoninë dhe ëmbëlsinë" e origjinalit. I pari që provoi të përkthente *Komedinë hyjnore* ishte Luigi Lorecchio, i cili në vitin 1896 ia besoi Jeronim De Radës botimin e një versioni në arbërishten e Pëhuriut Këngën I të *Ferrit* (v. 1-136). Disa vjet më vonë, vëllai i Luigjit, Anselmo, patriot i madh dhe aktivist i lëvizjes për pavarësinë e Shqipërisë, botoi në faqet e revistës *La Nazione Albanese* që kishte themeluar vetë, versionin gegë të episodit të Paolos dhe Françeskës (*Ferri* V, v. 88-142) përkthyer nga i riu shkodran Sakol Baazi. Gjatë atij fundshekulli nuk munguan studimet, si ai që Giuseppe Angelo Nociti botoi pjesërisht, apo imitimet rinore, si ato që ndërmori Zef Skiroi në bankat e liceut bashkë me mikun Luigi Pirandello, duke ngjallur kështu lëvdatat që profesori i tyre i dashur Mario Villareale përfshiu në një tingëllimë që ia kushtoi poetit të ri arbëresh: *Il divino Alighier non*



ti rincora, / che va cantando: Il nome di poeta / «È nome che più dura e che più onora»?

Shekulli i artë i përkthimeve danteske në shqipe ka qenë shekulli XX. Vincenc Prennushit i takon merita të ishte i pari shqiptar që në vitin 1924 ia hyri përkthimit të vargjeve të Dantes duke na dhënë në një shqipe elegante këngën e Shën Françeskut (*Par*. XI). Shembullin e tij e ndoqi Ernest Koliqi, përkthimet e të cilit i përkasin fillimit të viteve '30 të shekullit të shkuar. Versionet e pjesshme të përkthimeve të tij në gegërishte do t'u hapin udhën përpjekjeve të mëvonshme, disa prej të cilave shquhen për cilësi të lartë. Jo rastësisht shembulli i tij u ndoq nga i riu Pashko Gjeçi, i cili në vitet 1937-1938 botoi në revistën *Cirka* me pseudonimin *Surgens* disa pjesë nga *Ferri* (III, v. 82-136; X, v. 22-93; XXXII, v. 1-90), duke ia hyrë kështu një pune të gjatë që vetëm në vitin 1962 do të kurorëzohej me botimin integral të *Komedisë Hyjnore* në shqipe, me një parathënie të Llazar Siliqit. Puna prej pionieri e Gjeçit ende sot nuk është kapërcyer, paçka se me rënien e diktaturës pas vitit 1990 u ndërmorën disa përpjekje përkthimesh të pjesshme të veprës së Dantes. Ndër këto vlen të përmendim përkthimet e *Ferrit* të Çezar Kurtit (1996), të Hektor Shënepremtes (2017), dhe të Meritan Spahisë (2018), ky i fundit i vetmi i shoqëruar me shënime shpjeguese sipas modelit të botimeve italiane. Falë këtij parapëlqimi që ka pasur *Ferri*, na duket përsëri "e pashmangshme" të flasim për vuajtjet "e skëterrshme" që kanë hequr shqiptarët gjatë regjimit të Enver Hoxhës, sidomos të dënuarit politikë dhe intelektualët që patën fatkeqësinë të kalonin periudha pak a shumë të gjata në burgjet e Burrelit dhe të Spaçit. Në ato vende vepra e Dantes shfaqej si një ngushëllim, si një rreze e vagët shprese për t'u kthyer gjallë nga ai udhëtim absurd në ferrin ku i kishte flakur regjimi. Mjafton të lexohen titujt e romaneve të shkrimtarit Visar Zhiti (*Ferri i çarë*, *Rrugët e ferrit*) për të rrokur impaktin *që pati në jetën reale të shqiptarëve vepra e* Dantes gjatë atij gjysmëshekulli të historisë së tyre. Arbëreshëve u mbeti barra të merrnin stafetën historike, me Gaetano Gerbino-n që përktheu në arbërishten e Horës disa këngë të *Ferrit* dhe sot me përkthimin e guximshëm të Zef Skiro di Maxhos që vendosi ta kremtojë shtatëqindvjetorin e vdekjes së Dantes duke na sjellë arbërisht për të parën herë një përzgjedhje tingëllimash nga *Rimat* dhe nga *Vita Nova*.

Në vitin 1932 Ernest Koliqi kishte përkthyer dy tingëllima të famshme të Dantes: e para *Aq' e njerzìshme e aq' e hijshme gjanë* [*Tanto gentile e tanto onesta pare*] nga *Vita Nova* (XXVI), ndërsa e dyta, *Kisha me dasht' qi ty, Lapin e mue* [*Guido i' vorrei che tu Lapo ed io*], nga *Rimat*. Me këto përkthime Koliqi dëshmoi jo vetëm se e zotëronte në mënyrë të përsosur italishten, por edhe se ishte në gjendje të plazmonte më së miri poetikisht gegërishten në variantin e Shkodrës. Këtë e vuri në dukje edhe Martin Camaj në një studim që botoi në vitin 1962 ku theksoi aftësinë me të cilën qoftë Koliqi, qoftë Pashko Gjeçi në përkthimet përkatëse të *Ferrit*, ia kishin dalë t'u jepnin «vargjeve t'origjinalit veshjen e vërtetë e shijen e gjuhës shqipe». Në atë studim Camaj parashtroi edhe disa vërejtje kritiko-stilistike ku, veç të tjerash, evidentoi me mprehtësi dy qasje të ndryshme traduktologjike në përkthimet e Gjeçit: nga njëra anë kujdesin për të respektuar besnikërisht origjinalin dhe nga ana tjetër një farë lirie relative në shqipërimin e disa shprehjeve idiomatike të Dantes përmes frazeologjisë shqipe, asaj që gjëllinte në gjuhën e folur, ose asaj që ishte regjistruar *në* tekstet e traditës kanunore shqiptare. Sikurse e ka vënë në dukje Lisandër Kola në parathënien e përkthimit të *Ferrit* nga Meritan Spahija, kjo çështje ka të bëjë me disa aspekte teorike mbi të cilat u ndal Umberto Eco duke iu referuar sidomos vështirësive të përkthimit të Dantes. Largimi nga "skema e rendit të fjalëve të italishtes letrare, duke i qëndruar besnik mendimit të origjinalit" për Camajn nuk përbënte ndonjë problem, sikurse nuk përbënte problem mospërputhja kuptimore e disa fjalëve të përkthimit shqip me kuptimet e fjalëve të italishtes mesjetare të Dantes. Sidomos kur ishte fjala për neologjizma të shqipes që për shkak të moshës së tyre të re nuk ishin ngulitur mirë në ndjesinë gjuhësore të lexuesve. E gjitha kjo natyrisht duke mbajtur parasysh historinë e re të gjuhës poetike shqipe dhe të strukturës së saj jo vetëm *kuptimore*, por edhe *tingullore* e *ritmike*, çka për gjuhën e Dantes ka rëndësi të madhe.

Dante nga Salvador Dali

Këto vërejtje të cilave u shtohen ato të Umberto Eco-s mbi nevojën e një analize paraprake interpretuese të italishtes së Dantes, vlejnë edhe për vlerësimin e përkthimit arbërisht të rimave danteske nga Zef Skiroi. Përtej konsideratave që shpreh vetë përkthyesi në parashtresë, është vendi këtu të saktësojmë se teksti vjen në arbërishten e Horës së Arbëreshëve, fshati ku kanë lindur shumë intelektualë, mes të cilëve edhe poetë të shquar që i bëjnë nder letërsisë klasike dhe bashkëkohore shqipe. Pra një gjuhë që, sikurse gegërishtja, ka një traditë të konsoliduar poetike tek e cila mbështetet mjeshtërisht Zef Skiro, gjithë duke hedhur sytë herahera, nën shembullin e Pashko Gjeçit, edhe te gjuha e folur popullore. Zef Skiro dëshmon një profil të lartë traduktologjik edhe me disa zgjidhje "të pazakonta" që vihen re, për shembull, në përdorimin e sicilianizmave tashmë të konsoliduar në arbërishten e folur, të cilat, përtej konsideratave mirëfilli sociolinguistike dhe dialektologjike, i kishte përdorur edhe vetë Dantja. Që të bindemi për këtë mjafton të lexojmë diskutimin rreth përdorimit të emrit mashkullor të shqipes *malli* që nuk njihet në arbërishten e Horës, ku hasim rëndom emrin *dashuri* që lihet mënjanë nga përkthyesi ynë sepse, duke qenë i gjinisë femërore, nuk përkon gramatikisht me gjegjësin italisht *amore*. Pikërisht me këtë vëmendje për detajet Skiro vërteton se di të orientohet mjeshtërisht, nga njëra anë, në arkaicitetin e leksikut të arbërishtes së dëshmuar qoftë në traditën e poezisë së kultivuar, qoftë në atë që flitet në fshatin e tij, por edhe në ngulimet e tjera të shpërndara në gjithë Jugun e Italisë, nga ana tjetër në vitalitetin dhe modernitetin e shqipes së përbashkët. Rezultati përfundimtar është një kombinim i arrirë me vlerë të dyfishtë: ngrihet pa dyshim niveli i arbërishtes, që "fisnikërohet" në kuptimin dantesk të fjalës, por njëherazi shpërderdhet një pjesë e arkaicitetit të arbërishtes në shqipen e përbashkët, sidomos në atë ballkanike, duke e afruar atë në kohë me italishten mesjetare të Dantes. Të dyja këto aspekte janë të rëndësishme edhe në rrafshin e muzikalitetit të vargut që, pa u shtyrë në analiza të thelluara të strukturës së njëmbëdhjetërrokëshit të veçantë të shqipes, i garanton lexuesit shqipfolës kënaqësinë e "harmonive të ëmbla", të cilat Dante mendonte se mund të ruheshin vetëm në gjuhën origjinale. Edhe për këtë arsye po aq të rëndësishme sa të tjerat që zumë ngoje më lart, ky homazh në arbërishte i Skiroit vjen si *gur i çmuar* (*Par*., XV, 85-86) që zbukuron gjerdanin e historisë së takimit "të pashmangshëm" të shqiptarëve me Danten.

Guido, u deja se ti e Lapo e u vet

nga një magjepsje e madhe t'ishëm shpjerë
e vënë mbi një vark' sa me çdo erë
pas vllimit tëj dhe timit t' vej për det.
kshtu çë furtura o tjetër mot të shkret
ngë mënd na jipëj ndo pengim të tjerë
madje, tue rruar në të njëjtën vlerë,
sa t' rrijëm bashk' të kishëm më shum' et.
E zonjën Vanna e zonjën Lagia pra
m' atë çë te tridhjetat vargu ë shfaqur
i miri magjistar me ne t'i shtoj:
e ktu për dashuri tue fol' t' na shkoj
e nganjëra te ato t' ish e këndaqur
si kam bes' se dej' t' ishëm edhe na.

Sonet ABBA, ABBA, CDE, EDC

Dante fjandaks se Guido, Lapo e ai vetë si për magji të ishën rrëmbyer e venë te një varkë çë me çdo erë të vejë për dejt sipas dishirimit të tyre e të vet, ashtu çë as shtërgatë as tjetër mot i keq mënd të bëhej pengesë, madje tue rruar gjithmonë me një qëllim të njëjtë të i rritej dishirimi të rrijën bashkë. E dej pra se magjistari i butë të vëjë me ata zonjën Vana e zonjën Lagia e atë jetrën çë ndodhet tek i tridhjethti vend (bukurije) e dej se kish ligjërohej përherë për dashuri e se nganjera e atyreve të ish e këndaqur, ashtu si Poeti ka besë se dej t'ishën ata.

MREKULLIA SURREALISTE TE "VERA PA KTHIM" E BESNIK MUSTAFAJ

Prof.ass.dr.Maklena Nika

Një ndër veprat e Besnik Mustafaj që më ka lënë mbresa të jashtëzakonshme është romani "Vera pa kthim", i cili që në zanafillën e konceptimit dhe shkrimit të tij u lidh pashmangshmërisht me të rastësishmen objektive të surrealistëve francezë, një mbrëmje prilli të vitit 1985. Një bisedë e thjeshtë mes miqsh do të bëhej gjeneza e këtij romani.

E gjithë vepra, sipas atyre që shprehet edhe vetë shkrimtari, përshkohet nga dy kahet e kundërta të ekzistencës: dashuria dhe vdekja – erosi (surreal) dhe thanatosi (real), që konsistojnë në një binom shumë të dashur për shkrimtarin, të cilin e ndeshim edhe tek "Boshi". Për Marisa Kërbizin "Vera pa kthim" është një roman, që duhet të lexohet duke mbajtur në mendje sugjerimin e Renè Magritte se: *Shumëçka nuk është ashtu si duket* (*This is not a pipe*). Mbizotërimi i mendimit torturues të brendshëm, shpesh i distancuar nga kontrolli i arsyes, kthehet në njësi identifikuese për veprat surrealiste. Vepra të tilla shoqërohen nga teknika gjuhësore, që theksojnë paqëndrueshmërinë e arsyes, duke theksuar luhatjet e të pandërgjegjshmes. Kjo e pandërgjegjshme i jep veprës, nëpërmjet procesit të ëndërrimit, një ngjyrim defamiljarizimi me gjuhën dhe një prani kaotike të mendimeve.

Romani karakterizohet nga thyerje të rregullave drejtshkrimore. Thyerjet më të shpeshta lidhen me përdorimin arbitrar të shkronjës së madhe (("*a S'iSHTe e DHiMBSHMe Të BRaKTiSeJ aSHTu TRuPI NJë DiTë PReJ DiTëSH, Si Të MoS KiSHTe QeNë i yTi? TRuPi , PëR Të CiLiN ViTe Të TëRa, GJiTHë JeTëN, iSHe KuJDeSuR Më SHuMë Se PëR SHPiR-TiN?"*).

Ëndrra si proces i ndërlikuar psikologjik, gërsheton në roman një shumësi imazhesh dhe gjendjesh, nëpërmjet përdorimit të shkrimit automat i cili synon çlirimin e gjuhës, shfuqizimin e të gjithave rregullave estetike. Rrëfimi mbi ëndërrimin i jep romanit frymë surrealiste dhe krijohet e ashququajtura "Magjia e ëndrrave" *...ai erdhi krejt papritur dhe ishte mëngjes herët, ajo koha e ndërmjetme, kur njeriu ende është disi nën **pushtetin e ëndrrave** të natës e bile, jo rrallëherë, pa e vënë re ç'bën, priret t'u shtojë diçka nga **magjia ëndrrave e figurave reale që e rrethojnë**...*

Dashuria që Sana ndjen për Gorin është në vetvete e marrë, pasi nuk është reale dhe e prekshme. Kjo dashuri na kujton *amour fou* e surrealistëve francezë që i tejkalon kufijtë edhe të imagjinatës më të shfrenuar, tepër e ndjeshme në të gjithë veprën: "*...Reagimi i tij e shtyu Sanën të mendonte se mos vallë kishin lajthitur të dy? Të dy kemi lajthitur, tha gjithë kënaqësi. Siç jemi ne të dashuruar ...marrëzisht ...natyrisht që s'do ta kemi kokën të kthjellët...*" apo "*... ashtu është, iu përgjigj ajo pyetjes së vet, se gjithçka e bënte vetëm për t'i shërbyer **dashurisë** së Gorit...*"

Edhe humori i zi shoqëron thuajse çdo përshkrim apo skenë surrealiste. Si një humor shpotitës, ai ngjyros me një hije të errët edhe vetë mendimet e Sanës, që nuk nguron të përshkruajë çdo element, ndodhi apo mendim me humor tronditës në më të shumtën e rasteve, që shpërfytyrojnë edhe personazhet dhe hapësirat. "*...Ishin arsyetime që silleshin e përsilleshin në kokën e lodhur të Sanës, duke u rrotulluar nga të gjitha anët, **siç sillet brumi në brumatriçe** ...*apo: "*Sana besoi se nuk ishte më ajo e mëparshmja kur vuri re se nuk donte megjithatë të pranonte se tashmë për të ishte shumë vonë për të kërkuar të vërteta të tjera nga ato, me të cilat **ishte mësuar njësoj si me pakon 100 gramëshe të gjalpit që merrte në racionin e përmuajshëm te dyqani i lagjes**"*

E rastësishmja objektive, kryesisht e shprehur në takimet e rastësishme në roman të Sanës me të njohur e të panjohur krijojnë idenë se kjo e rastësishme luan një rol parësor në jetën e saj: "*... Sana e fsheu një ditë prej ditësh kutinë në një skutë, ku të mos e shihte më. Të paktën të mos ia zinte dora **rastësisht** tek kërkonte diçka tjetër. **Rikujtimi i rastësishëm** e bën brengën më të madhe...*".

Të gjithë elementët dhe imazhet e ndryshme surrealistë i japin romanit një frymë dhe një ngjyrim surrealist që në mënyrën e të rrëfyerit të historisë, të përjetimit të situatave, të ëndërrimit, të përfytyrimit, të imazheve, të të pandërgjegjshmes, të thyerjes së rregullave të shkrimit, të skenave dhe përshkrimeve surrealiste, të ngatërrimit të zërave të brendshëm, të shtresëzimeve dhe kapërcimeve surrealiste në kohë. Këto imazhe krijojnë **MREKULLISË SURREALISTE**. "*...nuk më besohet që erdhe. Kjo është mrekulli...*" apo: "*... ishte një magji, që asaj nuk i lejohej ta prishte me fjalë apo qoftë edhe duke çelur sytë. ...vështrimi i ngarkuar i Gorit zbriste ngadalë si një akrep me kthetrat ngulur pas lëkurës së saj...ajo ishte e tëra brenda kapërthimit të akrepit. ...dhe i vinte mirë... Dhe sa ngrohtë ndjehej aty! ...*" ose "*...Gorit, për shembull, mund t'i lëshojë dritë gjaku. Pse jo, mrekullirat janë mrekullira, pikërisht pse janë të pashoqe e të papërfytyrueshme në përditshmëri. ...vetvetiu gjithçka e tij bëhet e veçantë, tërheqëse, sepse është e mistershme, jo e rëndomte si tek të tjerët....*"

Kjo mrekulli surrealiste krijohet nga dy personazhe kryesorë surrealë, Sana është reale si individ që frymon, por surreale në mendime dhe ëndërrime. Gori ka qënë real, por interpretohet dhe përshkruhet në lidhjet e tij me Sanën si surreal. Edhe vetë dashuria e tyre është surreale, pasi konsumohet nga personazhe në thelb surrealë. Situatat, zhvillimet, përshkrimet, mendimet, veprimet janë surreale... Asgjë nuk ndodh në realitet, përveç se takimit të Sanës me shokun e luftës së të dashurit, dhe që prej këtij momenti fillon surrealiteti i Sanës e deri në fund...



ZUZANA FINGER:
LETËRSIA BASHKËKOHORE E VENDEVE SHQIPFOLËSE ËSHTË CILËSORE

Bisedoi Ledio Hala

Përkthimi, përpos faktit që e bën një vepër të gjallojë në një gjuhë tjetër, ndryshe nga ajo origjinale, është edhe një medium që realizon shkëmbimin kulturor mes kombeve të ndryshme. Pikërisht ky mision i përkthimit, si dhe kjo perspektivë që ofron, e bën rrjedhimisht përkthyesin ambasador kulture, pa të cilin vështirë se do të ekzistonte ndonjëherë komunikimi përmes artit, letërsisë, e kulturës. Kësisoj, jo rastësisht për lexuesin e Ex Libris, do të intevistojmë përkthyesen e mirënjohur, si dhe kryetaren e shoqatës „Martin Camaj" zonjën Zuzana Finger, e cila përkthen në gjuhën gjermane proza dhe poezi nga shqipja, çekishtja, hungarishtja dhe serbishtja. Zonja Finger në këtë 10 vjeçar të fundit me anë të përkthimeve të saj ka bërë shumë tekste të autorëve shqiptarë të flasin në gjuhën gjermane. Mund të përmendim këtu Musa Ramadanin, Ndriçim Ademajn, Kujtim Paçakun, Darien Levanin, Jeton Nezirajn, Parid Teferiçin, Gazmend Kapllanin, Ridvan Dibrën, Fatos Baxhakun etj.

Kur ka qenë kontakti juaj i parë me gjuhën shqipe, cila ishte shtysa që e mësuat këtë gjuhë, dhe pse vendosët të përktheni letërsi shqipe në gjuhën gjermane?

Kontakti im i parë me gjuhën shqipe ishte në mes të viteve '80 gjatë një udhëtimi në Kosovë. Që atëherë lindi dëshira ime për të mësuar shqip. Pas kthimit në Berlin fillova të mësoj shqip te prof. dr. Norbert Reiter, i cili ishte udhëheqesi i Ballkanologjisë në Freie Universität në Berlin. Ndërsa për motivimin që të përkthej letërsi shqipe i jam mirënjohëse shoqes sime Neviana Dosti.

Duke ndjekur rrjedhën e përkthimeve tuaja duket qartazi që jeni e orientuar nga autorët bashkëkohorë shqiptarë. Pse kjo zgjedhje?

Pjesa më e madhe e përkthimeve të mia është e lidhur me porosi konkrete p.sh. për leximе në panairin e librit në Leipzig, për antologji, për shfaqje teatrale, dhe në këto ngjarje prezantohen tekstet dhe po ashtu edhe autorët personalisht, të cilët në këtë mënyrë marrin pjesë në dialogun kulturor ndërkombëtar. Domethënë në Gjermani ka institucione dhe lexues, të cilët janë të interesuar të dinë çfarë shkruhet në vendet shqipfolëse sot dhe kush janë dhe si mendojnë autorët shqip me të cilët dëshirojnë të takohen dhe të njihen. Letërsia bashkëkohore e vendeve shqipfolëse është cilësore dhe lexuesit europianë përfitojnë shumë si bashkëkohës.

Cilat janë vështirësitë që hasni në përkthim, e më konkretisht në përkthimin e letërsisë shqipe?

Gjuha shqipe zhvillohet shumë shpejt dhe përkthimi vetëm me fjalorë standardë nuk është i mundshëm, nëse përkthyesi nuk e ka gjuhën shqipe si gjuhën amtare. Për këtë arsye për mua është e domosdoshme të kontaktoj autorët dhe të konsultohem me ta. Arian Leka më ka përkrahur jashtëzakonisht gjatë përkthimeve dhe i jam shumë falënderuese sepse falë tij kam zgjeruar jo vetëm njohuritë e mia të gjuhës shqipe por edhe të albanologjisë. Sfida e dytë e përkthimeve është se secili autor përfaqëson një kozmos estetik të veçantë dhe mua më duhet

të krijoj një vepër adekuate në gjuhën e ndryshme. Nuk duhet të jem e dukshme unë si përkthyese. Çdo autor duhet të njihet si një zë individual. Përkthimi është interpretim, njëlloj si interpretimi i një vepre muzikore, si dhe përpjekje e riprodhimit të origjinalit me mjetet e një gjuhe të ndryshme, në sfondin e ndikimeve dhe përvojave të tjera kulturore.

Nga veprimtaria juaj me përkthimin e letërsisë shqipe, a do të veçonit disa tekste letrare që janë më të preferuarit për ju e që vërtet kanë lënë gjurmë në punën tuaj?

Me shumë qejf përkthej drama. Falë zonjës Alida Bremer u krijua para rreth 15 viteve kontakti midis meje dhe Jeton Nezirajt dhe ndërkohë ai është autori im më i përkthyer. Për këtë vazhdimësi jam e lumtur. Njëkohësisht përcjell zhvillimin e tij në zhanerin e dramës, dhe po ashtu edhe zhvilloj aftësitë e mia në gjuhën e teatrit.

Në këndvështrimin tuaj si përkthyese, si e shikoni të tashmen por edhe perspektivën e letërsisë shqipe?

E admiroj dhe e çmoj pasurinë dhe gjallerinë e madhe të letërsisë shqipe, sidomos numrin mahnitës të poeteshave dhe shkrimtareve të reja të shkëlqyeshme. Autorët shqiptarë krijojnë në kushte të vështira, sepse tregu i librave të mirë është i kufizuar dhe rrallëkush lexon poezi. Me krijimtari letrare nuk mund të sigurohet jetesa dhe kjo vlen me disa përjashtime të vogla edhe për Gjermaninë.

Si perceptohet letërsia shqipe nga lexuesi gjerman ose gjermanishtfolës? A ka interes të vazhdueshëm në leximin e saj?

Në përvojën time ka shumë interes për autorët e mirë të letërsisë shqipe sepse ajo konsiderohet akoma si letërsi pak e njohur. Botoj përkthime të poezive shqip në revista të ndryshme gjermane dhe austriake dhe lexuesit i perceptojnë si diçka thelbësore në përmbajtje sepse në to trajtohen çështje të rëndësishme që na prekin të gjithëve. Tendencë inkurajuese është se numri i botimeve të autorëve shqip falë kolegëve të mi përkthyes është në rritje.

Në krahasim me përkthimet nga çekishtja, hungarishtja e serbishtja, a zënë përkthimet nga shqipja pjesën më të madhe të veprimtarisë suaj si përkthyese? Nëse po, ka të bëjë kjo me një preferencë tuajën, apo me një dëshirë të lexuesit?

Në të vërtetë, përkthimet nga shqipja zënë gjithnjë pjesën më të madhe të veprimtarisë sime. Gjatë përkthimit zhvillohen marrëdhënie personale me autorët dhe interesi im për veprat e tyre vazhdon. Në këte mënyre bashkëpunimi me Anna Kove, Blerina Rogova Gaxha, Ardiana S. Prishtina, Shpëtim Selmani, Arben Idrizi, Xhevdet Bajraj etj. ekziston që prej shumë vitesh dhe shpresoj se do të vazhdojë edhe për shumë vite të tjera.

Rreth tregimit "KULLA" të Anton Pashkut

VETËDIJA MITIKE E QENËSISË DHE E QËNDRESËS

Nga Anton Nikë Berisha

Asnjë antologji e tregimit shqiptar, hartuar mbi bazën e kritereve letrare poetike, nuk do të mund ta linte anash tregimin "Kulla" të Anton Pashkut. Themi kështu duke pasur parasysh faktin se ky tregim nuk është vetëm ndër më artistikët brenda krijimtarisë tregimtare të autorit e të prozës tregimtare shqiptare në përgjithësi, por është edhe ndër më komplekset si qasje e si shtjellim, si strukturë tekstore dhe si sistem i ndërliqshëm kuptimor, e si rrjedhojë e gjithë kësaj, edhe krijim me një kontekst poetologjik jashtëzakonisht të pasur, për shumëçka i papërsëritshëm.

Çka e bën të këtillë këtë tregim?

Shqiptim artistik i mitit të kullës

Në qenësinë e vet tregimi "Kulla" ngrihet mbi mitin për kullën, që nënkupton mitin për qenësinë, për ekzistencën dhe për qëndresën e njeriut tonë në rrjedhë të shekujve. Mbi bazën e përvojës historike, e cila materializohet e metaforizohet në mënyrë të veçantë në këtë prozë, shqiptohet dhe interpretohet një botë komplekse, realitet, që në esencë është vetëdije mitike e krijuar në një diakroni të pafund të ekzistencës. Në tregim nuk jepet as platforma, as modeli i gjallimit, nuk jepen as përgjigje për problemet e ndryshme e as për shkaqet e krijimit të mitit të kullës, por shqiptohet qenësia e këtij vetëdijesimi; në të nuk gjakohet e vërteta e thjeshtë historike - në kohë e hapësirë të veçantë - pra nuk transponohet realiteti i zhveshur, por perceptohet e shprehet thellësisht rrafshi metafizik i kësaj ekzistence si dhe padrejtësia metafizike, që u manifestua në rrjedha të kohës. Me fjalë të tjera, në këtë prozë nuk bëhet qartësimi i rrjedhave dhe i fakteve të njohura historikisht, i personave e i ngjarjeve konkrete, por mbi bazën e përvojës historike, që lidhet sidomos me dramën, tragjiken, me qëndresën e me sakrificat, krijohet realiteti i veçantë, i cili, nxitur nga fakti historik, bëhet qenësi, bëhet fakt i ri, fenomen i realitetit dhe i botës shpirtërore. Në të vërtetë, kjo qenësi artistike e krijuar merr funksion të dyfishtë: shpreh qenësinë e së kaluarës e të tashmes, i bën ato artistikisht të përjetshme, por bëhet edhe vetë pjesë e pandashme e veprimit, e konkretësisë ekzistenciale; njëherit krijon bazën e perspektivës së të ardhshmes. Duke shprehur dhe duke bërë njësimin e kohëve - përmes rrëfimit - tregimi "Kulla", gjithnjë si projeksion artistik i vetëdijes, merr përmasën e theksuar mitike. Në esencë shqiptimi i objektit artistik, mënyra e qasjes dhe e interpretimit të qëndresës së njeriut tonë në rrjedhë të shekujve, nuk pohohen, nuk shprehen në mënyrë eksplicite, gjë që është e lidhur ngushtë me mënyrën e shtjellimit të strukturës së tekstit e të gjuhës së përdorur poetike. Përkundrazi, "Kulla" është krijim që ngrihet mbi një bazë që cilësohet me një sistem jashtëzakonisht të veçantë të të shprehurit thellësor. Po qe se këtë e themi me termat e gramatikës gjenerative të Çomskit, atëherë gjithë ajo që trajtohet në këtë prozë, konkretësia e metaforizuar, ngjet në rrafshin thellësor, ku përqendrohet dhe realizohet thelbësisht gjithë proza e këtij autori (ajo tregimtare dhe romaneske), por dhe dramat e tij. (Pikërisht kjo thellësi e perceptimit, e transponimit dhe e trajtimit të çështjeve të ndryshme i ka shtyrë disa studiues të theksojnë "hermetizmin", "moskomunikativitetin" e kësaj proze, të pohojnë se tregimet e tij janë "fantastike", që shprehin botën obsesive të autorit, pra janë pa objekt konkret trajtimi, pa bazë reale!) A. Pashku mitin për kullën, që në esencë shpreh mitin për qëndresën dhe ekzistencën, nuk e shpreh dhe nuk e shqipton me gjuhën dhe me stilin që e cilëson mitin si lloj letrar e si formë e transponimit të fenomeneve të botës metafizike. Tregimit të vet Pashku nuk i jep përmasën sakrale, me të cilën cilësohet miti, por sakralitetin e zëvendëson me shumëkuptimësinë, me krijimin e strukturës tekstore nga e cila del mesazhi artistik dhe krijohet një kontekst poetologjik i pasur, që është i lidhur ngushtë me gjuhën poetike. Pikërisht gjuha poetike në këtë tregim, si dhe në prozën e tij në përgjithësi, merr karakter mitik në kuptimin e forcës shprehëse artistike dhe amshueshmërisë së funksionimit dhe të ekzistencës së saj.



Rrënimi - zhvendosja e konvencave

Tregimi "Kulla" nuk ka një objekt artistik të thjeshtë - tradicional, ku do të mund të ndiqeshin rrjedhat e gradacionit të fabulës (ndodhisë): fillimi, etapat e zhvillimit, mbarimi. Ai nuk është i ndërtuar mbi një ide qendrore, as nuk përdor vetëm një formë të rrëfimit, të monologut, të dialogut etj.; objekti i tij është një shumësi objektesh artistike, një spektër, një mozaik tërësor, ku pjesët nuk janë krijuar mbi bazën e radhitjes hierarkike, por janë krijuar e funksionalizuar mbi bazën e krijimit e të forcimit të tërësisë shprehëse e kuptimore, të tërësisë së ndikimit estetik, duke u lidhur e duke u plotësuar me njëra tjetrën nga rrafshe e forma të shumta e të ndryshme, qofshin kur ato ndodhen në raport të ndërsjellë kushtëzues e determinues, qoftë kundërvënës e kundërshtues. Mënyra e perceptimit, e shtjellimit dhe e shqiptimit të objektit artistik në tregimin "Kulla" në esencë shprehet si rrënim i konvencave të prozës së realizmit, pra në këtë krijim rrënohen - zhvendosen konvencat e fabulimit dhe narracionit tradicional. Në vend të parimit hierarkik e të kronologjisë, me çka cilësohet proza tradicionale, në tregimin "Kulla" vendosen lidhje shumëplanëshe paradigmatike; krijohet një sistem kompleks paradigmatik, që nuk veçohet për përshkrimin, vlerësimin, shpjegimin, pohimin, por për thellësinë dhe begatinë e shprehjes, për krijimin e realitetit sa më të ndërliqshëm e të pavarur artistik. Ndërtuar mbi parime të këtilla është krejt e natyrshme që për të depërtuar në strukturën tekstore e në sistemin kuptimor, që del nga struktura gjuhësore e tregimit, kërkohet më shumë përkushtim e dije, pra perceptimi dhe receptimi i "Kullës" është i vështirë. S'do mend se kjo vështirësi nuk nënkupton abstraksionin e objektit të trajtuar në këtë prozë, por përkundrazi, ndërliqshmërinë, shumështresinë dhe pasurinë e strukturës gjuhësore tekstore. Pra rrënimi i konvencave të prozës tradicionale nuk është vlera kryesore e këtij tregimi, por para se gjithash mënyra origjinale e vrojtimit, e shtjellimit të tekstit poetik, e ndërtimit të tërësisë shprehëse e kuptimore nëpërmjet të pjesëve, të cilat shprehin forcën e tyre qenësore në krijimin e tërësisë si kohezion i përbërësve kryesorë të krijimit letrar-artistik dhe si forcë e ndikimit estetik te marrësi.

Uniteti i rrafsheve kundërvënëse - kontrastike

Proza "Kulla" është ndërtuar mbi bazën e dy rrafsheve të ndryshme kundërvënëse, të cilat mu në raportin kontrastik të tyre shprehin madhështinë e tërësisë, kohezionin e tyre. Tregimi është perceptuar si një sistem i antitezës poetike, jo për të theksuar pavarësinë e rrafsheve kundërvënëse brenda strukturës tekstore, por për ta shprehur, në nivelin sa më të lartë, unitetin shprehimor dhe kuptimor, që krijojnë mikrostrukturat e krijimit artistik në rrafshet e këtilla kontrastike. Në këtë prozë, siç theksohet qysh në faqen e parë, çdo gjë që ngjet - ndodh: *fillonte prej dikah thellë në pafundësi dhe mbaronte diku lart, por gjithashtu thellë në pafundësi.* Në këtë diakroni të pakufi (skaje të kundërta paradigmatike) nëpërmjet të formave të ndryshme të shqiptimit, autori fut një varg elementesh të shumësisë së objektit artistik. Dhe pikërisht raportet e krijuara midis këtyre elementeve, si sistem mikrostrukturash në raport me makrostrukturën, veçoritë shprehëse e kuptimore, forca që ato marrin brenda strukturës së tekstit, shprehin disa nga tiparet kryesore e origjinale të këtij tregimi dhe të Pashkut si prozator.

Rrafshet kundërvënëse paradigmatike të "Kullës" janë, me një anë: *tymi, errësira, fillimi i natës, heshtja, shikimi i ngrirë, hapësira e përhimtë, kjasina, rëra përvëluese, lot e tym, galtina, gërmadhat, kulet, kulja e madhe fantazmagorike, psherëtima, gjaku, hejza, zapullima, thika, thika në sy, zëri i përvajshëm, pylli (që) ka sulmuar kullën, kasapi (si njollë) më e errët si errësira, kukuvriqi etj.,* ndërsa në anën tjetër: *kulla, plaka, bardhoka, tarrabeci, kali, kreu i rrënjëve, delta e lumit, zogjtë, këmbora, dielli që në ag zinte të flakëronte etj.* Këto dy rrafshe janë jashtëzakonisht të lidhura e të varura midis tyre; nga aspekti tematik dhe kuptimor ata nuk synojnë hierarkinë. Në vend të këtij raporti, që shpesh e ndeshim në krijimet tona letrare, ata varën e kushtëzohen në mënyrë të ndërsjellë; i cilëson një varësi e brendshme, qenësore,

sepse në këtë mënyrë e bëjnë më të plotë imazhin, ashtu siç ngjet edhe me mesazhin poetik, që del si rrjedhojë e ballafaqimit dhe e funksionalizimit të tablove, të situatave e të mendimeve brenda strukturës së veçantë tekstore.

Raporti kontrastik nuk shprehet vetëm në ballafaqimin e dy rrafsheve, që i përmendem, por edhe brenda një rrafshi. Kështu, fjala vjen, kjo shprehet me vdekjen dhe jetën e plakës, e cila është kreu i rrënjëve; për të mësojmë vetëm pas vdekjes; vetëm pas këtij akti shpaloset esenca e veprimit dhe e simbolizimit të saj; mbas varrimit ajo përtërihet në kujtesën e njerëzve, sakralizohet simbolika e rrudhave, e rrënjëve të saj. Ngjashëm ndodh edhe me kullën: ajo ekziston ndërmjet qëndresës dhe rrënimit - shkatërrimit; atë e mban gjallë dhe e ripërtërin këmbora, e cila, përkundër pësimeve të kullës, është e pazhdukshme, e paasgjësueshme. Pra plaka vdes, por nuk vdes esenca e qenësisë, e simbolikës, e funksionit të saj, nuk vdesin rrënjët, siç nuk zhduket e nuk asgjësohet kulla, po prej mbetjeve (gërmadhave, kuleve etj.) ringjallet, vazhdon ekzistimin dhe qëndresën. Ky ekzistim dhe kjo qëndresë në tregimin "Kulla" marrin një përmasë mitike, e cila bëhet pjesë e vetëdijes dhe merr tiparin sakral. Dhe sa më shumë që kulla (bashkë me këtë edhe qëndresa) pëson, sa më shumë që ndihet prania e kuleve, e gërmadhave, e kulprave (që kanë veshur gati të gjitha muret e kullës dhe kanë zënë të hyjnë edhe nëpër frëngji), dega e rrapit (që don të hyjë ndërmjet gurëve të kullës) etj., aq më tepër ajo bëhet më e qëndrueshme, siç bëhen më konzistent e shenjëzues kryet e rrënjëve, këmbora, tarrabeci, delta etj., që koekzistojnë fuqishëm brenda tërësisë; ato varen dhe i japin njëra tjetrës në nivele e përmasa shumëplanëshe:

"Paj, si të them, më vonë, disi, nuk më pëlqente ta krahasoja (plakën) vetëm me rrënjë".

"Por, rrënjët janë të bukura!".

"Janë, por nuk më duket se kryet e plakës sonë mund t'i ngjante vetëm kreut të rrënjëve të thella".

"Kurse mua më duket se mund t'i ngjante vetëm rrënjëve që s'ndahen dot nga thellësitë e veta".

Imazh vetëdijsor dhe kohë mitike

"Kulla" nuk është as prozë fantastike, as e ngritur mbi bazën e ëndrrës, as shprehje e realitetit të mirëfilltë historik; ajo s'është as realitet i modelit të përrallës, që shprehet si kundërvënie e realitetit të vërtetë, si mohim i tij. Siç theksuam edhe më parë, realitetin, faktin historik ky tregim e merr vetëm si bazë, si nxitje, si motivim, si rrafsh bazor njohës - njohje që nuk është e rastit, siç nuk është asgjë e rastit në këtë prozë për shumëçka komplekse.

Realiteti i tregimit "Kulla" qenësisht lidhet me përvojën e historisë kombëtare të popullit tonë, që është krijuar në vetëdije si refleksion i konkretësisë historike. Ky realitet, kjo empiri historike, shprehet nëpërmjet një shumësie çështjesh, veprimesh, situatash, personazhesh, objektesh, shpresash të rrëfimit dialogësh etj. Nëpërmjet shumësisë së objekteve të trajtuara, krijohet një gjerësi e thellësi, një unitet i qëndrueshëm e funksional, që e shpreh më plotnisht realitetin, mundëson, nëpërmjet strukturës tekstore poetike, shqiptim dhe interpretim më kompleks të tij. Pra kjo shumësi, pos tjerash, shpreh përshtypjet e ndryshme subjektive të personazheve ndaj realitetit të njëmendtë objektiv (në kohë të ndryshme), që është qenësore për qasje moderne, sepse në këtë mënyrë shmanget mundësia e subjektivizmit të një personazhi (sipas Erich Auerbach-it). Veprohet në këtë mënyrë për arsye se vetëdija, natyrisht edhe krijimi i veprës letrare mbi bazën e funksionimit të saj, siç ndodh dhe në tregimin "Kulla", nuk është e varur nga rrjedha kronologjike (term i David Daiches), nga ndodhitë, vijimësia e veprimit, i mendimit etj., por në formë sistemi (zbatohet edhe paralelizmi), ajo anticipon dhe vepron në retrospektivë. Nëpërmjet aluzioneve dhe kundërshtimeve të brendshme qenësore, krijohet në vetëdije rrjedha e ballafaqimit të dukurive në raporte kundërvënëse e kundërshtuese, pra krijohen të gjitha mundësitë për unifikimin maksimal të rrëfimit, që në kushte të tjera, të shqiptimit tradicional të realitetit objektiv (bardh-zi, mbi bazën e varësisë së rrjedhës kronologjike etj.) ose të imitimit të tij kjo do të bëhej pjesërisht ose nuk do të mund të bëhej fare. Në këtë mënyrë brenda vetëdijes, rrjedha e ngjarjeve, perceptimi i imazheve, shqiptimi i botës së personazheve veprojnë pavarësisht nga kategoria e kohës dhe e hapësirës, pra fushëveprimi në diakroni e sinkroni është i pakufi.



Personazhet në tregimin "Kulla", si dhe në gjithë prozën e tij tregimtare madje dhe në romanin "Oh", nuk janë asgjë tjetër pos shenja, figura në funksion (term i Gunther Anders-it), në të vërtetë janë funksione, që brenda strukturës tekstore, funksionalizohet në tërësinë e sistemit kuptimor, gjë që për A. Pashkun gjithnjë ka rëndësi të dorës së parë. Kjo tërësi si e tillë pastaj do të krijojë një nëntekst të veçantë që e bën këtë tregim artistikisht më konzistent. Mënyra e perceptimit dhe e shqiptimit shumindividual në vetëdije, shprehimësia e shumëfishtë në vetëdije (term i Auerbach-it) nuk është çështje e re për letërsitë e tjera. Mirëpo Pashku është origjinal në këtë tregim, sikur se në gjithë prozën e tij, sepse nuk ndjek e nuk imiton asnjë autor që krijon sipas kësaj mënyre, edhe pse prej tyre ka mësuar në mënyrë kreative. Ai ndryshon prej të tjerëve për këndvështrimin e problemeve, për kompleksitetin e varësisë dhe të raporteve që i krijon në strukturën gjuhësore, pastaj për të "folurit e përjetuar", për "monologun e brendshëm", për "sigurshmërinë objektive". Pra Pashku dëshmon origjinalitetin pikërisht për funksionet dhe sistemimin e përbërësve brenda tërësisë, brenda konceptit artistik të krijimit, duke i parë në dritën e empirisë historike nacionale. (Në qoftë se, fjala vjen, për Kafkën bota në përgjithësi është objekt i frikës dhe i qëllimit, në këtë tregim bota shqiptohet si raport i ndërsjellë i tragjikes dhe i qëndresës).

Mënyra komplekse e perceptimit të botës e të dukurive të saj dëshmohet në këtë tregim edhe me përdorimin e kategorisë së kohës. Në esencë koha e prozës "Kulla" është kohë që ngjet në vetëdije; është pjesë e vetëdijes, prandaj ajo është e pakufi; i përket të kaluarës, të tashmes dhe të ardhshmes. Kjo mënyrë e perceptimit të kohës i jep asaj përmasën mitike, por njëherit edhe përmasën e objektivimit. Nëpërmjet të kohës së "jashtme" dhe kohës së "brendshme", kohës "reale" dhe kohës "subjektive" zgjerohet mundësia e perceptimit thellësor e kompleks, e integrimit të shumësive shprehëse e kuptimore, e shpalimit të shumësisë së shtresave të vetëdijes historike, por edhe të vetëdijes transcendentale, metafizike. Duke përdorur kohën në këtë mënyrë krijohet mundësia për t'u thelluar e për ta kuptuar më thellësisht realitetin ekzistues, por edhe të perspektivës së kohës dhe të simbolikës gjithëpranuese të ndodhive (sipas E. Aurbach-it). Kjo formë krijon mundësinë e projeksionit të të folurit mitik, i cili në këtë mënyrë e krijon realitetin e ri; nga rrafshi i empirisë historike kalon në vetëdije e prej aty, nëpërmjet të artit të fjalës, e pasuron atë realitet nëpërmjet rrëfimit që shndërrohet në shenja dhe si i tillë funksionon në formë të mëvetësishme. Kështu, plaka, kasapi, tarabeci etj., janë refleksione të realitetit historik, por nga realiteti "real" janë transponuar në realitetin "subjektiv" i cili në tregim funksionon si i pavarur dhe i mëvetësishëm, si përvojë e re.

Koha "reale", e "thjeshtë" në prozën "Kulla" është fare e shkurtër: nis me fëllimin e natës e mbaron po ashtu me fëllimin e asaj nate. Ndryshimi midis fillimit dhe mbarimit të kësaj kohe ekziston. Në fund të tregimit thuhet: *"[...] dhe fëllimi i natës, që përvidhej nëpër frëngji. Më duket se është afruar agu".* Koha "fiktive", "subjektive", e "brendshme" është e pakufishme (diakroni e pafund). Në esencë gjithë koha - kohësisht shumë e gjatë - e tregimit "Kulla" zgjat në vetëdije, siç ngjet edhe në romanin "Oh", por dhe në disa proza të tjera të këtij autori. Kjo kohë preferohet, përfillet e përdoret nga Pashku për arsye të krijimit të hapësirës sa më të madhe, të pakufishme për shtrirjen e rrëfimit, unifikimit të shtresave të tij, për të shqiptuar probleme komplekse të realitetit jetësor, që manifestohen e koekzistojnë në formë tjetër në vetëdijen e njeriut, në vetëdijen si qenësi sintetike aktive. Pikërisht shprehimësia e shumëfishtë e vetëdijes ndonjëherë shkakton hutimin e lexuesit të këtij tregimi ose krijon përshtypjen se ai është abstrakt, tejet i "ngarkuar", së këndejmi i vështirë për kuptim. Kjo ngjet për shkak se Pashku në këtë prozë e thyen konceptin e kronologjisë së ngjarjes, rrëfimit, veprimit, të shqiptimit të karaktereve, të situatave. Ai me qëllim e përqendron vëmendjen në detaje të "parëndësishme", por që sugjerojnë dhe krijojnë kontekst kompleks qenësor, nëpërmjet të të cilëve në mënyrë të pabesueshme, shprehet dhe vërehet pasuria e realitetit dhe thellësia e secilit çast që i jepemi pa qëllim (Auerbach). Mbi bazën e perceptimit të këtillë të çështjeve e të dukurive të ndryshme nga qenësia e përvojës së historisë sonë, Pashku krijon një realitet artistik të papërsëritshëm. Dhe po qe se në tregimin "Kulla" ka diçka që ngrihet mbi të tjerat, që synon të mitizohet në mënyrë konzistente, atëherë ky mitizim shprehet para se gjithash në rrafshin e thënies artistike, si vlerë gjithëkohor. Nëse në këtë kontekst mund të bëhet fjalë për krijimin e mitit të prozës shqipe si art, si vetëdije artistike, atëherë Pashku me tregimin "Kulla" i ka dhënë një nga përmasat më të thella, ka arritur njërën ndër pikat më të larta.

Botohet vëllimi poetik "Thuaja hënës", i Vehbi Skënderit, në 10 vjetorin e ndarjes nga jeta të poetit

POEZIA E VEHBI SKËNDERIT, BOTËVËSHTRIM NËPËRMJET BUKURIVE NJERËZORE

Nga Skënder Buçpapaj

"Poeti e shikon botën ashtu si burri e shikon gruan." Rrallëkujt mund t'i shkojë sa Vehbi Skënderit dhe poezisë së tij ky përcaktim i poetit amerikan të shekullit të kaluar Wallace Stevens.

"Thuaja hënës", i cili po iu propozohet lexuesve në dhjetëvjetorin e ndarjes së poetit nga jeta dhe 26 vjet pas botimit të parë, është një nga stacionet e kësaj poezie. Është libri i dymbëdhjetë poetik i tij dhe i pari pas largimit të diktaturës së Enver Hoxhës e Ramiz Alisë. Ky libër vjen shtatë vjet pas librit të tij të mëparshëm "Nxitoj", shtatë vjet, pra që poeti të freskojë mjaftueshëm muskujt dhe frymëmarrjen e poezisë së tij sa për të dalë përsëri para publikut të tij admirues.

Libri botohej më 1995, në fillim të moshës së tretë të poetit. Askush nuk mund të parashikonte askohohe se hapte një fazë të re dhe më të lartën e poezisë së Vehbi Skënderit, as vetë autori i tij me një karrierë nga më origjinalet e brezit të tij krijues dhe të krejt poezisë shqipe të pas Luftës së Dytë Botërore. Ndryshe nga shumë prej kolegëve të penës të atij brezi, ai nuk vinte nga universitetet e huaja, por formohej, njëherësh nxënës dhe profesor i vetvetes, duke formuar vetë shkollën e tij poetike.

Nuk e kishte kritikën zyrtare sa e kishte me vete publikun admirues, i cili zgjerohej e zgjerohej pas çdo botimi të ri. Librin e parë e sjell kur është 26 vjeç. Me librin "Fletë nga ditari im" ai është i përkëdheluri i lexuesit të breznisë së re si "Anakreont i poezisë shqipe". Përqaset me njërin nga nëntë lirikët më të mëdhenj të antikitetit greke, ngaqë tematika e tij më e parapëlqyer

është ajo e dashurisë, larg çdo skeme, pra, edhe larg skemave të imponuara nga realizmi socialist. Ai tashmë e shikon botën nëpërmjet bukurisë së femrës, nëpërmjet bukurisë së ndjenjës për femrën, duke i shkrirë në një rrafsh të vetëm njerëzoren me hyjnoren, tokësoren me qielloren.

I vetmi veteran i Luftës së Dytë Botërore nga radhët e shkrimtarëve me tri plagë plumbash në trup, Vehbi Skënderi gjatë karrierës së tij krijuese të pasluftës, do të ketë shumë plumba dhe shumë plagë. Merr goditjen e parë nga regjimi kur është 38 - 39 vjeç, kur është afirmuar si poet e gazetar, kur ka fituar çmime republike e çmime në konkurse kombëtare. Përballet me riedukim të detyruar disavjeçar në kantieret e Vaut të Dejës, i fillojnë presionet e Sigurimit të Shtetit, të cilat nuk i ndahen gjatë gjithë regjimit. I ndalohet krijimtaria, librat i hiqen nga libraritë dhe nga bibliotekat i dërgohen për karton. Përballet me dëbimet, me papunësinë, pastaj me punët më të rënda e më poshtëruese. Edhe kur "i lejohet krijimtaria", nuk lejohet promovimi i kësaj krijimtarie nga kritika, pra është në liri e skllavëruar, me pikatore.

Dy librat e botuar pas lejimit të krijimtarisë, janë "Kumbojnë vitet" (1984) dhe "Nxitoj" (1988), dy tituj me të cilët jepet alarmi se koha po i ik fluturim poetit, natyrisht, pa denoncuar dot autorësinë e krimit ndaj tij dhe poezisë së tij.

"THUAJA HËNËS..." APO KËNGËT E PAKËNDUARA

Vehbi Skënderi, nga të gjitha lirikat zgjedh "Bëjmë sikur..." për titull të librit të tij të ri në kushtet e lirive estetike të krijuara. Tri pikat e heshtjes kanë peshë të madhe shprehëse të mëdyshjes dhe të dyshimit të poetit ndaj pritshmërive të panjohura në horizontin e kohës. Ndjenja nuk është mes dashurisë dhe urrejtjes, është mes lojës dashurore dhe çmendjes dashurore, mes mërzisë së kotësisë, boshit, monotonisë dhe dehjes së haresë, magjisë, shpresës, mes gënjeshtrës dhe së vërtetës. Poezia përfundon me vargjet: "Thua më do vërtet, vërtet çmendesh për mua?/ A bën sikur. Sikur. Sikur.../ Dhe as ti nuk më do. Dhe as unë nuk të dua! Veç lozim komedi./ ... E nga kjo kotësi, që ndesh ngado të shkosh:/ Gjithçka të duket kot! Gjithçka të duket bosh!" Në mes të ndjenjës ndërhyn kështu parandjenja, e cila nuk vë thjesht hendek mes dy inividëve, midis dy të dashuruarve njëherësh të padashuruarve, por midis njeriut dhe shoqërisë, midis shoqërisë dhe kohës.

Me këtë libër poeti do të dëshmonte se nga i gjithë brezi i tij është krijuesi që e jeton dhe e shpërblen më me sukses dhe më frytshëm lirinë. Dhe më vonë nga libri në libër ai do të rilindte e do të rilindte përsëri. Kështu më 2000 do të vinte libri "Hëna e vjedhur", më 2004 do të vinte "Zvicra, Shqipëria ime", më 2012, një vit pas largimit të tij nga jeta, do të vinte libri "Mirëmëngjesi, Shqipëri - Lirika të një tetëdhjetëvjeçari", secili me një fizionomi më vete, secili në një lartësi të re. Nga një libër në tjetrin shpërthejnë akumulimet e heshtura, akumulimet e fshehura edhe ndaj vetë poetit, me flatrat e frymëzimeve të reja që nuk e përfillin moshën e shtyrë të poetit.

Ndoshta, kur është fjala për një poet të përndjekur e të ndaluar, librit "Thuaja hënës" do t'i kishte shkuar edhe titulli "Këngë të pakënduara". Poeti këndon këngët që, me dekada, nuk ia kishin lejuar t'i këndonte, i hedh në vargje frymëzimet që ia kishin mbajtur peng, e lëshon zërin e tij jashtë kafazit të dogmave të praktikuara nga institucioni më i vrazhdë i censurës në gjithë ish kampin socialist, jashtë frustrimeve të autocensurës të imponuara dhunshëm nga sistemi dikatorial.

Poeti nuk rifillon nga aty ka e ka lënë me librin e tij të para shtatë viteve, e rifillon aty ku e ka lënë para 32 vjetësh, pra, me lirikat dashurore, me optikën, me botëvështrimin e lënë në mes në vitin 1963. Por tashmë ai e ngre zërin me disa oktava më lart.

Libri ka 77 lirika, të përmbledhura në tetë cikle. Cikli i parë "Mos ik" është edhe më i gjati. Nga 25 poezi të tij, 24 janë lirika dashurore. Ndërsa i gjithë libri ka 44 lirika dashurore. Paralajmërohet, pra, kështu jo vetëm lënda e një libri, por edhe një stinë e begatë poetike, ku muzës së tij i rikthehet integriteti i plotë, ajo nuk është më hija e vetvetes, nuk është më gjysma e vetvetes, ajo është hënë e plotë.

Dashuria nuk është vetëm ndjenjë eterike, është edhe lëndore, është edhe fizike. Nuk iu këndohet vetëm syve, zemrave, shpirtërave, përmallimeve,

takimeve, ndarjeve, kujtimeve, harrimeve, pikëllimeve, iu këndohet edhe gishtave, duarve, buzëve, vetullave, qerpikëve, pulpëve, kërthizave, pushit të faqeve, gjoksit, gjunjëve, iu këndohet deri edhe "zonave të ndaluara", "zonave të palejuara" apo "zonave të pushtuara", iu këndohet edhe ndjenjave të rrezikshme për "gruan e një tjetri", edhe ndjenjave të çuditshme të pamoshë. Iu këndohet shumë pritjeve, iu këndohet shumë përjetimeve, gati asnjëherë ndarjeve, iu këndohet edhe dyshimeve në dashuri, edhe mërzitjeve në dashuri, edhe ndjenjave të lënduara, por të gjitha nga pafajësia, e cila është sinonim i bukurisë, pra sinonim i femrës. Si te asnjë poet tjetër, te Vehbi Skënderi, në çdo rrethanë, të xhelozisë, të refuzimit, të ndarjes, femra është pafajësia.

Dhe vjen poezia që ndokush mund ta akuzojë si blasfeme "Unë kam shkruar një Bibël për vetullat e qerpikët", një poezi manifest i bandillit modern: "Unë që i kam sfiduar erotikët. Dhe heretikët./ Që kam ngritur një Bibël për vetullat e qerpikët;/ Që jam katitur rrugëve dhé e pluhur (Fshehur kaçubeve të mrejgullave e muzgjeve) veç për të puthur pak këmbën tënde të bukur)/ Të kam shpletitu leshrat, kopsat të kam shkopsitur.../" Më tej: "Të kam thithur, si pite mjaltë, buzën e tharë nën hënë". Apo "Të kam zhveshur sa herë: golf, bluzë e këmishë/ Të kam puthur plot zjarr: sy, buzë e kërthizë".

NDJESHMËRI GJITHËSHQISORE

Lirika dashurore e Anakreontit shqiptar bëhet gjithnjë e më trupore, ku ndjesia jo vetëm jo vetëm përjetohet shpirtërisht si hijeshi, si sharm, si bukuri femërore, pra si përkryerje e bukurisë njerëzore, por edhe fizikisht si njomështi, butësi, ëmbëlsi, kur poeti i thotë së dashurës në lëndinë, në stolin e parkut apo në shtrat: "Dhe unë që buroj plot vrull lumenj në fjalë dhe emëra abstrakte/ Më pëlqen të hyj rrugicave e ngushticave (pa dritë)/ të mistereve e të shpellave me shumë kate". Dhe më tej: "Mbaroj për këtë trup! Këto dy duar e këto dy buzë/ dhe këta sy të zes... që mbushin shpirtin plot tym/ plot re e shkrepëtima..." (Poezia "Tani ti je e tëra e imja")

"Poeti e shikon botën ashtu si burri e shikon gruan." Thoshte poeti amerikan Wallace Stevens. Me anasjellë, mund të arrijmë edhe në përfundimin tjetër se edhe bota i reagon si gruaja poetit. Shkëmbejnë mes tyre joshjet, tundimet, zotërimet, kureshtjet, intimitetet, ndijimet, bashkëveprimet, ndërveprimet.

Dhe mund të themi se poezia e Vehbi Skënderit është pikërisht poezi e shqisave burrërore, pra poezi e sensualizmit mashkullor, e ndërveprimit të dendur e të larmishëm të shqisave brenda tërësive trupore partnerëve në dashuri, ku vihen në punë sa më gjerësisht të gjitha shqisat: shikimi, dëgjimi, prekja, nuhatja, shijimi. Kjo ndihet, natyrisht, më shumë tek lirikat dashurore. Mund të veçoj këtu për analizë disa vargje nga poezia "Qimkëzat" (ndoshta e vetmja në poezinë botërore me këtë temë), e cila ka në qendër pushin e faqeve të femrës së dashur: "Po këto qimkëzat e tua si gjilpëra/ Oh! Këto qimka, që përhapin tinguj si zilka/ E më bëjnë kaq të prekshëm e sensibël!/ ... Sikur fishkëllejnë heshtazi, si bilbilka/ Sikur më cimbisin lehtazi, si çimka./ Oh! Këto qimkëza të hijshme, si gjilpëra/ u fryjnë halkave të pishave e të ëndërrave..." Brenda këtyre vargjeve shfaqen krahas njëra tjetrës dhe bashkë disa ndjesi, secila më e bukur, përveç shikimit edhe prekja, sepse qimkëzat janë si gjilpëra që i ndjen edhe në largësi, por që cimbisin lehtas kur ato të prekin apo kur ti i prek, përveç shikimit dhe prekjes edhe dëgjimi se ato fërshëllejnë edhe pse "heshtazi", se ato luajnë edhe në instrumentet e tyre, sepse "u fryjnë halkave të pishave e të ëndërrave". Ndjesitë shqisore ndërveprojnë edhe si mbresa të ruajtura gjatë në kujtesën e elementëve fluidë apo të ngurtë të natyrës: "Nuk do ta kisha besuar.../ Po mos të kiste ruajtur ajri ende erën tënde/ Dhe rëra kapriçioze e plazhit gjurmët e tua". Atë që e bën ajri i plazhit në poezinë "Nuk do ta kisha besuar" e bën uji i detit në poezinë "Ajo që kërkon ti".

Përmasa bodleriane është gjithnjë e më e dukshme në poezinë e Vehbi Skënderit. Bukuria femërore shndërrohet në një lente nëpërmjet së cilës poeti, në prani a në mungesë të saj, e shikon edhe të shëmtuarën, të ligën, tragjiken, të cilat aq shpesh, aq pamunngueshëm ndeshen në përditshmërinë njerëzore. Bukurinë femërore, edhe nëse "rri si zog i strukur" në "thes të pistë me arna "që nxin si re nga kandrat", edhe nëse shëmtohet në "xhingla-migla, kopsa, tela, teneqe, edhe nëse e ndryn brenda çdo gëzhoje, brenda çdo ambalazhi të shëmtuar e të neveritshëm, nuk mund ta fshehësh, sepse ajo "Prap shkrepëtin, si diell, tri herë më e bukur!", sepse "Ajo shkrep përsëri, si hëna mes një shkrepe!", sepse ajo "ndriçon si zjarr, si yll përshkënditet", "dhe kur e nxjerr ne ankand dhe kur e kall në hije". (Perla) Magjia e bukurisë e sfidon edhe vetë vdekjen: "Kleopatrën e magjishme a s'e kafshoi nëpërka nga shporta e fiqve?" Bukuria e sfidon edhe vetë vdekjen, sepse vetëm ajo nuk i trembet vdekjes: "Asgjë nuk i shpëton asaj! Askush! Askund!/ Vetëm prej sa nuk trembet/ Ajo që edhe shelgut frikacak, edhe lisit trim i qepet pas si kulpra/ E nga vështrimi i saj edhe Perëndia çmendet:/ E bukura! O Zot i Madh! E bukura! E bukura!"



TJETËR PËRMASË BODLERIANE

Poeti Vehbi Skënderi, me librin "Thuaja hënës", këndon plot këngë të pakënduara, thyen plot tabu të deriatëhershme. Ai lë pikëtakime të reja kujtese me fëmijërinë, ai ritakohet pas sa dekadash me Dibrën e adoleshencës së tij partizane. Për herë të parë, drejtpëdrejt në sy, pa tërthore, i flet edhe vdekjes. Për herë të parë përballet me vuajtjet e tij të një gjysmë shekulli, për herë të parë nuk iu druan lotëve të tij, nuk iu druhet vetmive, trishtimeve, marrëzive poetike, për herë të parë përballet, pa teklif tashmë, me sfidanten më të rëndë e më jofalëse ndaj njeriut, madje të njeriut poet - pleqërinë. Për herë të parë, ai fiton të drejtën për të protestuar ndaj fatit të padrejtë të Kosovës me dimër aq të gjatë dhe pranverë aq të shkurtër ("posi një lulekuqe mes dëborës").

Përmasa bodleriane vërehet gjthnjë e më fuqishëm në marrëdhëniet herë më të lëmuara, herë më të ashpra midis kategorive të kundërta estetike, të cilave në realitetin jetësor iu përgjigjen dukuri përkatëse herë të pajtueshme e herë armiqësore mes tyre. Nëpërmjet bukurisë dhe pafajësisë fëminore, tek poezia "Dy ushtarët" poeti sjell ndërvënien e përkryer të tragjikes dhe groteskes. Sepse e tillë, makabre, ngjethëse, e habitshme, e kobshme, komike dhe unikale është vdekja që iu ofron toka e huaj, toka shqiptare, një ushtari grek dhe një ushtari italian, dy pushtuesve, që vazhdojnë të mbajnë njëri- tjetrin nëpërmjet bajonetave të ngulura njëri-tjetrit dhe të cilët bora që po shkrin ua zbulon para syve kureshtarë femijëve të luftës. Është një statujë që iu mungon të gjitha galerive të botës, përveç galerisë aq të pasur të poetit Vehbi Skënderi.

Fëmija është dukshëm te plaku, kur ky i përjetëson në poezi dy të ndërvrarët e Luftës së Dytë Botërore. Fëmija është dukshëm te plaku edhe tek poezitë që ia kushton Dibrës, ku ai ka qenë partizan dhe, bashkë me plumbat në trup, ka marrë mbresat më të pashlyeshme të një jete shumë të gjatë në vite, shumë të ndërlikuar nga pësimet, shumë të rënduar nga zhgënjimet. Fëmija është padukshëm te plaku në të gjitha poezitë e ciklit "Vdekja vjen gjithmonë herët". E thotë titulli i ciklit, por edhe titujt e poezive: "Burgu", "Kur më fiksohet bindja se edhe pak ditë më mbeten", "Kam një të mirë: unë mbaj mend", "Prit, o i verbër, prit", "Vdekja" e tjerë. Te "Epitaf i nipit për gjyshin e vet veteran vrarë si armik i Partisë" fëmija e kupton plakun dhe plaku fëmijën se jeta që iu është shërbyer ka qenë një lugë - më keq se të ishte bosh - një lug plot helm. Një lojë fëminore sa dhe një tragjedi. Përballë vdekjes, burri, plaku është me armët e fëmijërisë, me armët e kujtimeve, të përjetimeve, vuajtjeve, pendimeve, me imunitetin e fëmijërisë është burri ai që e mban në këmbë njeriun. Dhe bashkë me të - botën!

RIKTHIMI

Sikurse e cekëm, "Thuaja hënës" u botua herën e parë kur kriza mes lexuesit shqiptar dhe letërsisë shqipe kishte marrë çarje të madhe që vetëm sa do të thellohej, kur nga censura më e skajshme e botimeve u kalua në improvizimet më të skajshme, në maniera nga më të hallakaturat e nga më boshët, kur shoqëria ishte plotësisht e hutuar dhe e shushatur ndaj vlerave të vërteta. Ribotimi i librit në dhjetëvjetorin e ndarjes së poetit nga jeta, e rikthen tek lexuesi poezinë e Vehbi Skënderit në shenjë të rikthimit të lexuesit shqiptar tek poezia më e mirë shqipe, tek letërsia më e mirë shqipe.

DITË LEXIMESH NË PARKUN E MADH TË LIQENIT

Nga Xhevair Lleshi

Ditë me diell të bukur. Puku, vogëlushi Puku, që zakonisht prehet mes librave dhe lodrave, kësaj radhe zgjodhi të bëjmë së bashku me mua një shëtitje nga liqeni. Vetëm kur mbërrita tek Teatri Veror m'u duk se ai duhet të ishte njoftuar (ndoshta prej facebook-ut të tij të çuditshëm!) për të lexuar librin e ri të afishuar në anën e majtë të rrugës buzë liqenit. Puku vuri putrën e vogël te pllaka e llamarintë ku ishte shkruar : «Shëtitje e tregimeve» 1-21 qershor, Parku i Madh i Liqenit, për fëmijët – dhe të rriturit, për të shijuar leximin dhe natyrën në të njëjtën kohë. Por Puku nuk po donte të largoheshim më tej. Kishte ngelur diçka? Po. Ishte edhe teksti anglisht. Puku e çoi, ngritur vertikalisht, i mbështetur në dy këmbët e pasme, me putrën e bardhë si bora mbi shkronjat anglisht: «Dog's colorful day» nga Emma Dodd.» Më tej Puku qeshi. Dielli edhe ai qeshte. Frynte një fllad i lehtë pylli. Diçka e mahnitshme. Me këtë fllad duket se gjithçka filloi dhe mbaroi. Dhe bashkë, të dy, i lexuam ngadalë, në të dy gjuhët. E mora në duar Pukun e vogël, zemra e të cilit punonte me ngut të madh, me një tik-tak që të kujtonte orën e krevatit të gjumit, si në një çast dashurie të krisur. Ndërkohë dëgjonim *muzikë klasike në kufje* dhe gati ishim të këndonim të dy (e ç'këngë do të qe! Gati pa zë dhe në diell. Dielli i qershorit në Tiranë dhe sidomos në Parkun e Madh të Liqenit është i Jashtëzakonshëm!). I lexuam të 16 pllakëzat e llamarinta, me ngjyra. Dhe, edhe shëtitjen e bëmë po edhe lexuam një histori me qenush. Puku shikonte me një lloj egoje qenushin e tregimit dhe vihej re tek ai xhelozia. Xhelozi qeni! Kohë leximesh në park. Filloi, thashë me vete, një kohë e shkujdesur, thjesht për të përmbushur një kënaqësi të paprovuar më parë...

Më kujtohet kur shëtisnim me Nensin e vogël, mbesën, para njëzet vitesh në buzë të këtij liqeni, por ja që u deshën njëzet vjet të gjejmë një tregim të parë. Një nga miqtë e mi, më ngacmoi: E mo, u je vënë leximeve? Ç'të bësh! – iu përgjigja. E ka fajin Lali Eri dhe shpirti i tij krijues. Nëse e ka krijuar Lali Eri, unë i them një Bravo të madhe! Ashtu siç i thashë po këtë bravo, teksa shëtita me Pukun e vogël me treninon plot me pasagjerë (me gjyshër e fëmijë!), shoqëruar me foto pa fund, nën një gjelbërim që ta mbush shpirtin plot, po edhe me ajër të mrekullueshëm... Sa mbaruam leximin, në rrugën përplot hije dolën me vrap nga pylli vajzat e një skuadre volejbolli me veshje sportive. Një grup vajzash të bukura, pa pikën e grimit, me një freski të mrekullueshme (edhe Puku e pati zili!), paksa të djersitura, me pikla djerse si pikla vese në qerpikë dhe me buzët e ngarkuara me të kuq gjaku, më të kuqe se trëndafilat që bëjnë merak njerëzit tek «Dinasty» në rrugën e Kosovarëve, drejt Digës së Liqenit, përballë dy kullave harkore, siç thonë të Ndragetës... I thashë edhe Pukut se ato kurme gati më dukeshin si të punuara me dorë, aq fine e të zhdërvjellëta ishin, ndërsa vraponin lehtë në bulevardin tekanjoz të liqenit, i cili duket po aq i jashtëzakonshëm edhe në ditët me shi... I shikoja nga afër dhe po më merrej fryma prej një tundimi të fortë. Po ti? - sikur më thoshin sytë e Pukut me një thërrime trembjeje. Pastaj na rrëmbeu muzika klasike e kufjeve dhe u harruam prej saj. Befas po fishkëllente flladi. Dikush na krijoi rrymë në vrap e sipër, ishte një sportist truplartë, e pa Pukun që iu gafrrua dhe ai, sportisti, u përkul duke e puthur qenushin e bukur me emrin Puku. Tani më ngacmojnë veç aventurat e Pukut!... Ditën tjetër mbase lexojmë një tregim tjetër, Puku! Por s'më ha buza kulaç. Do të na duhet kohë derisa ta shohim përsëri këtë lloj elegance leximore. Ok? Më kuptove? ... Dhe u endëm më tej, nën diellin e bukur të qershorit në Parkun e Madh të Liqenit...

Tiranë, më 10 qershor 2021,
Një ditë vërtet e mrekullueshme
Ndoshta pse është Dita e Lidhjes Kombëtare
të Prizrenit

(Prend Buzhala: "Psherëtima pergamene", poezi, zgjedhjen dhe parathënien: Anton Nikë Berisha, "Rozafa", Prishtinë, 2017)

ARTI QË SHENJTËRON

nga Sarë GJERGJI

Emri i Prend Buzhalës, në historinë e letërsisë shqipe dhe kulturës shqiptare përgjithësisht, lidhet me studiuesin e letërsisë, kritikun letrar, eseistin, poetin, prozatorin e publicistin. Është zëri më i veçantë, tejet i fuqishëm e me shumë ndikim, që tek lexuesi përcjell me shumë përkushtim dhe kompetencë të lartë profesionale, rrjedhat e gjithmbarshme jo vetëm letrare e kulturore.

"Dy format e krijimtarisë së Prend Buzhalës: studimi i letërsisë dhe përftimi i veprave letrare poetike e ndihmuan dhe e plotësuan njëra – tjetrën dhe të dyja së bashku bëjnë tërësinë dhe plotninë e figurës së tij krijuese dhe i sigurojnë atij një vend të qenësishëm në letërsinë tonë." Kështu shprehet studiuesi i mirënjohur i letërsisë, Anton N. Berisha, në parathënien e vëllimit poetik *Psherëtima pergamene*, poezitë e së cilës edhe i përzgjodhi.

Vepra në fjalë, është një dramë më vete, e cila duket se vjen nga fillimi i botës, ose nga vendi (amë) ku fillon jeta dhe vdekja, drita dhe terri, miti dhe realiteti, dashuria dhe urrejtja, liria dhe lufta, njerëzorja dhe hyjnorja; vjen si një proces e rrugëtim i pandërprerë i kohëve, i pikave kulminante që kanë pikasur ato.

Libri është ndarë dhe sistemuar në nëntë cikle me gjithsej 140 poezi dhe në fokus ka çështje nga më të ndryshme të jetës dhe artit. Ndonëse poezitë vijnë nga libra të ndryshëm të Buzhalës, elementi kryesor i përbashkët është syri kritik mbi realitetin dhe një ton plot ngjyra, kur ironik e përcëllues, kur me një kolorit pranveror.

Buzhala zgjedh tema, ngjarje e dukuri të larmishme, tunduese e intriguese, që sa lidhen me aktualitetin, po aq reflektojnë edhe të kaluarën e mitiken. Temat, ndërkaq, sa përkojnë me botën amë, po aq janë dhe universale. Poezia lind nga ankthet e tij, nga vëzhgimi i tij i saktë i kohës dhe hapësirës (F. Matos)

Libri flet për shumëçka që kemi harruar e për gjithçka që nuk duam të themi, duke shpërfaqur kështu, një mendje të uritur (të autorit) për drejtësi dhe integritet në të gjitha rrafshet e nivelet. Pikënisje e shumë poezive, shpesh është kontrasti midis dritës dhe errësirës. Është një lloj shtytje imagjinare në tema të densitetit të thellë, në një moment kur qenia jonë (si individ, shoqëri e komb, në raport me vetveten dhe të tjerët) tregon shenja stërkeqjeje. Ato i trajton me një gjuhë mjeshtërisht të jashtëzakonshme.



Kushdo që e njeh Prend Buzhalën, pajton me mendimin se ai shquhet për një konceptim të veçantë të jetës dhe artit. Vetë vargu buzhalian, poetika e tij, lë mundësi për një shumësi interpretimesh. Gjuha me fuqinë e saj, në poezinë e Buzhalës, mundëson ndërtimin e imazheve të shkëlqyera poetike, ndërkaq metafora, mes burimeve të tjera, e pasuron jashtëzakonisht shumë mesazhin. Këto, bashkë me simbolet dhe figurat e shumta, ironinë, sarkazmin, paradoksin, alegorinë, epitetin, antitezën, kontrastin, paralelizmin, pyetjet retorike, etj., janë përtej një mikrokozmosi në veprën tejet komplekse dhe shumështresore të Buzhalës. Vërtet, siç do shprehej Lotman, *teksti poetik paraqet një strukturë komplekse artistike.* Si i tillë, në vëllimin poetik *Psherëtima pergamene,* shtron shumë çështje e hap shumë dilema, edhe të natyrës ekzistenciale.

Poezia e tij është jo vetëm moment, jo vetëm çast shenjtërimi i gjendjes, i qenies sonë. Fjala, së cilës i këndon, në analogji më filozofinë biblike, në këtë vepër është e shenjtë e shenjtëron për amshim:

Fjalën shqipe s'ke si ta pjesëtosh, as gjakun si ta ndash së bashku me prangat.

Ati ynë, mund të shkojmë në kalvar, vetëm të jetojë Fjala Shqipe. (Kur erdhi çasti i ringjalljes, Atë Luigj Palajt)

***

Poezia e Buzhalës sjell historinë, përditshmërinë dhe realitetin, kohë, ambiente e kultura të ndryshme, në një mënyrë të përpunuar dhe mahnitëse poetike, duke përftuar një realitet të ri poetik. Vargu i tij kërkon një marrëdhënie më të sinqertë me vetë natyrën tonë, me të tjerët e me gjithçka tjetër; një poezi që, pareshtur, na sjell sfidën për të kërkuar pak më shumë nga vetja jonë.

Buzhala në poezinë bashkëkohore shqipe është edhe një shembull i mrekullueshëm se si mund ta shkurtojmë vargun pa humbur bukurinë e poezisë (poezitë Haiku...).

Vërtet, lexuesi mbahet peng i vargut mahnitës të Buzhalës.

Autori këndon e rrëfen me një urtësi të gjallë, me një urtësi solomonike. As shpreh ekzaltim, as ftohtësi të tepruar. Nëse gjërat për të cilat shkruan, në dukje janë të përkohshme (në fakt edhe gjërat e vogla dalin të jenë gjigante në poezinë e P. Buzhalës), arti i tij është i përjetshëm. Gjithçka ka një masë dhe një rend të mirëmenduar.

Arti i tij është fruta që duhet korrur e shijuar; është një pemishte vargjesh që ngërthejnë brenda vetes aq shumë diell e dritë edhe kur flet për terr e demonë.

Si i tillë, vargu i Buzhalës vjen edhe si një lloj katarse që pastron e fisnikëron shpirtin.

Duke njohur mendimet e Platonit e të Aristotelit për filozofinë dhe artin poetik - poezinë, mund të themi se Buzhala në këtë vëllim poetik na vjen edhe si filozof (i denjë për *shtetin ideal* **të Platonit), edhe si poet. Ndërkaq, në pajtim me pohimin e H. Bloomit se** *poezia është një thirrje profetike që meriton pa diskutim kurorën e letërsisë imagjinare*, atëherë mund të themi me plot gojën se vëllimi poetik *Psherëtima pergamene* është dëshmia më e mirë e kësaj kurore.

ATË ALI TOMORI NAIM FRASHËRIT

nga Mehmet Gëzhilli

Flag' e zjarrit të mallnjimit shpirt' e trup m'i bëri zhurr
I vuar prej hidhërimit do të mbetem zemër-gurr.
Edhe në arthtë durimi të më japë ngushëllimin
Cili është ngushëllimi, për veç teje, o Naim?
Çastin që më lindi mëma, ulërita me vajtim
Pse më solli këtu gjëma?... derdha lot me drithërim.
Se m'u ndodh një ëngjëll afër e në vesh me zë më tha:
Fjal' e parë çun' i mitur: në kët' jetë prehje s'ka!
Por me vrap më mori mëma, mëm' e dashur pa kufi
E më zu' një frym e lehtë kur më vu' ajo në gji
Më dha qumështin e shijshëm e më tha se Zoti vet
Ka mëshirë, fal dhurata, jep fuqi e jep shëndet.
. . . . . .
Biro' të më kesh shëndetin, të më jesh për mbarësi
Të kesh mendjen e vullnetin me dëshir' e dhëmpshuri
Të përvetòsh diturinë, të shërbesh në njerëzi...
Do të nginjesh me uzdajë - të jap fjalën që nashti.
Ajo frymë, ajo fjalë, fjal' e mëmës që më zgjoi
Më dha dorën e më ngriti edhe udhën më tregoi,
Udhën e kopshtit të bukur anës detit në Ballkan
Ku bilbili fort zë-shkul herë qesh e herë qan.
Ku bilbili me mall shumë nxjerr të ëmbël melodi
Që çon luanin prej gjumit e i thot për Shqyptar
Tundu! Merr armët në duar, të të shohin bota sot
Rrobëria s'të ka shuar, je i gjallë luftëtar.
. . . . . .
Rrobëria s'të ka shuar! Shqipëtar si ndëkur je'
Fisin, famën, trimërinë, përdori për atdhe.
Se atdheu i liruar edhe kombi me lavdi
Lumtëri e sotme janë - të bëj be: Për Perëndi.
Këto fjalët e Naimit pàrëhèrë kur dëgjonj
Nip' i Lekës dhe Skënderit mori forcë dhe gulçoi,
Tundi krahët, pà fuqinë, gjithë botës ja diktoi
Gjallërin' e tij të vjetër vjershëtori siç këndoi.
E prandaj kjo flag' e zjarrit shpirt e trup m'i bëri zhurr
I vuar prej hidhërimit që të mbetem zëmër-gurr!
Edhe në arthtë durimi të më japë ngushëllim...
Cili është ngushëllimi?... Vjersha jote, o Naim!

20 prill 1929

AQSH i RSH,
F. 819, d. 47; fl. 24-25, origjinal,
dorëshkrim shqip.

Do të dëshironim që sot ta kishim këtë ditë si një ditë feste, ku të nderonim, të meditonim dhe të festonim 125-vjetorin e lindjes së Baba Ali Turabinit, i cili po 125 vjet më parë lindi në Shalës të Tepelenës.

Tepelena ka lindur burra të dëgjuar, si për pallë e trimëri, dhe për penë e mençuri, por ajo Tepelenë nxori edhe një bektashi, nga më të diturit, më të kënduarin e më të kulturuarin, që, po ta shikojmë si njeri të besuar të fesë bektashiane, por që dinte te nderonte dhe respektonte çdo besim të të tjerëve, ta shohim si gjuhëtar e gazetar, si poet e përkthyes, folklorist dhe historian, filozof dhe mendimtar, sa i urtë dhe i mprehtë, ai i gëzon dhe i plotëson këto kualitete.

Por mbi të gjitha këto dhunti që ai gëzonte, ajo që e përshkroi gjithë jetën e tij, ishte atdhetarizmi i kulluar, i pastër su ujët e Vjosës që shushurit përjetësisht në këmbët e Tepelenës.

Ai ishte sa atdhetar, aq edhe fetar, ishte sa fetar, aq edhe patriot i kulluar, por me një fund tepër tragjik.

Por sot në 70-vjetorin e pushkatimit dhe të krimit makabër ndaj tyre jemi mbledhur për të përkujtuar atë së bashku me Baba Shefqet Gllavën, jo duke mbajtur një kumtesë, referat a diçka tjetër, por për t'u bërë një homazh nderimi e përkujtimi, për të thënë me dhimbje e pikëllim të thellë dy fjalë zemre për ata dy martirë bektashinj që u martirizuan në moshën dhe në kohën më të duhur, që atdheu kishte aq shumë nevojë për njerëz të ditur e të shkolluar.

Baba Ali Turabiu pasi mbaroi shkollën fillore në vendlindje, u rrit e u edukua me bëmat legjendare të të parëve të vet, që sillnin erërat e serta të Tepelenës, që kanë ardhur nëpër shekuj. Më pas studion në gjimnazin "Zosimea" të Janinës, që mund ta quajmë universitetin më të mirë të kohës.

Në gjimnazin "Zosimea" kishin studiuar shumë atdhetarë shqiptarë, dhe po aty kishin studiuar mendjendriturit, vëllezërit Frashëri, Naimi e Samiu.

Dhe aty, jo vetëm studioi Baba Ali Turabiu, por u bë idhtari më besnik i rrugës që shtruan vëllezërit Frashëri. Më pas, për t'u kompletuar me arsim e kulturë perëndimore, ai studion në Francë, dhe si për ta vazhduar rrugën që kishin ndjekur një numër i konsideruar baballarë tepelenas, edhe ai iu përkushtua fesë bektashiane, duke filluar karrierën e vet në Teqenë e dëgjuar të Prishtës, më pas në teqenë e famshme të malit të Tomorrit, duke u ngritur në shkallën më të lartë, të kryegjyshit, në Teqenë e Gjirokastrës.

Por Baba Ali Turabiu, jo vetëm iu përkushtua dhe praktikoi ritet e fesë bektashiane, por kontributi i tij qe i gjithanshëm, duke u përpjekur të krijonte e plotësonte me shkrime gazetareske, me krijime artistike, me poezi e përkthime, me studime të mirëfillta historike, synonte të krijonte literaturëne domosdoshme bektashiane. Ai është historiani më i plotë, më i saktë dhe më i gjithanshëm i historisë së bektashizmit në Shqipëri dhe më gjerë.

Kur e pyet një profesor që ka mbetur anonim, se a kanë bibliotekë dhe bibliografi bektashinjtë, ai i përgjigjet: "Po, kemi.", megjithatë ai bie në mendime dhe përqendrohet se çfarë ishte krijuar dhe çfarë duhej krijuar ende.

Baba Ali Turabiu ka meritën që jo vetëm ka marrë pjesë, por ka qenë organizator dhe sekretar i kongreseve bektashiane në Prishtë të Skraparit, në Turan të Korçës dhe në Gjirokastër. Si shumë dokumente, ashtu edhe projekt-statutet e hartuar, mbajnë penën dhe dorën e tij.

Baba Ali Turabiu dha kontribut të veçantë për realizimin me sukses të këtyre kongreseve, por ai i pasqyroi gjerësisht në shtypin e kohës.

Krijimtaria e Baba Ali Turabiut, e përcjellë me një sërë pseudonime, përfshin të gjitha gjinitë e pasqyron gjithë problemet, shqetësimet e hallet e kohës.

Ai përjetoi masakrat e vitit të mbrapshtë 1914, ku shovinistët grekë jo vetëm masakruan deri gratë dhe fëmijët, por dogjën dhe shkatërruan edhe vendet e shenjta, siç qe edhe fati i teqesë së Prishtës, ku pasi e ropën me gjithçka, i lanë vetëm katër muret. Baba Aliun dhe dervishët e tjerë i ndoqën për t'i masakruar, por ata mundën t'u shpëtonin, duke shkuar larg në Egjipt. Baba Aliu për këtë i drejtohet me një letër therëse, demaskuese gjithë ironi, ministrit të mbrotjes greke.

Baba Aliu shkruan dhe është i bindur se Teqeja e Prishtës do të ringrihej, por ajo që do të mbetej e pashklyer dhe e dënuar përjetë, ishte ndëshkimi i ndërgjegjes dhe i krimeve të shovinistëve grekë.

"...Neve s'duam të dimë shtëpij' e Zotit jonë është e begatëshme, do të viren në vent përsëri ato sendet e rrëmbyera, por emër' i ushtrisë rrëmbenjëse të Greqisë do të jetë i qërtuar përjetë ndë istori."

Dhe më tej ministrit grek i kujton se meqë varfë Alinë nuk arritën ta kapnin e ta coptonin, ai u përgjigjet: "Me varfe Alinë or qirje kalanin, do të hasni këto ditë në Përmet, i cili në vend të ligësivet që i bëtë, do të marrë shpagë duke u bërë mirësi e duke hedhur shkëndijat e dritës së bashkimit e vëllazërisë në trutë tuaj të ndryshkura!!!"

("Liri e Shqipërisë", 20 mars 1914, f.2)

Baba Ali Turabiu edhe në Egjipt iu përkushtua artit dhe shkencës duke i zgjeruar njohuritë e tij, duke studiuar nëpër bibliotekat e pasura, të thesareve egjiptiane.

Baba Ali Turabiu njeh në kuptimin më të mirë të fjalës, poetët klasikë, që nga Homeri, Danten, Shekspirin, poetët francezë, poetët persianë, duke i studiuar në origjinal, por edhe debatuar lidhur me veprat e tyre.

Kjo e bëri atë që të ngrejë probleme të mprehta për gjuhën, letërsinë e filozofinë e kohës.

"Para çdo pune ndaj përparimit letrar, me nevojën më të domosdoshme është puna e botimit të një fjalori të plotë. Fjalori i Kristoforidhit është i vlefshëm për gjuhën tonë përpara botimit të librave të Naim Frashërit dhe të Jan Vretos; i vlefshëm vetëm sa të diktohej faza e ringjalljes së një gjuhe klasike, siç ishte atëhere gjuha jonë e pashkruar."

"Gazeta e Korçës", 11 shtator 1936, f. 3

Është ndër të parët që ngre lart punën e veprën e Kristoforidhit dhe fjalorin e tij, por siç thotë Baba Turabiu, ose Baba Ali Tomorri, që duhej me domosdo hartimi i Fjalorit të Gjuhës Shqipe.

"... Gjuha jonë është mjaft e pasur, një pjesë e pasurisë së saj është e pazbuluar, dhe që të zbulohet, (revolohet), nuk do punë vetëm me kartë dhe punë mbi tryezë.

Do një punë të palodhur alakristoforidhiane, duke ardhur pa rrjeshtë në takim (kontakt) me popullin, më shumë m'e atë pjesë të popullit që nuk di të shkruajë e të këndojë mbi kartërat, dhe megjithë këtë të metë, di të kuvendojë në fjalë të qëruara."

"Rilindja", Korçë, nr. 14, 15 qershor 1935, f.11.

Është i pari që ngre problemin e përdorimit të emrave shqiptarë, si për meshkuj, dhe për femra, duke dhënë shembuj me një mori emrash ilirë të botuar në shtypin e kohës.





Ngre me shumë forcë përsosjen e gjuhës shqipe dhe shkruarjen e saj saktë. Ai arrin në përfundimin se është kjo gjuha shqipe që na çoi në çlirimin dhe pavarësinë e Shqipërisë më 1912, dhe e mbajti gjallë dhe që jeton edhe sot kombi shqiptar.

Përzgjedhja dhe rekomandimi i emrave pellazgo-ilirë tregon se sa i lidhur ishte Baba Ali Tomori me historinë, gjuhën dhe kulturën shqiptare.

Po përmendim vetëm pak emra, si për djem dhe për vajza.

Për djem:

Akil, Piro, Omir, Lekë, Klito, Arjan, Skënder, Bardhyl, Muzakë, Arianit, Perlat, Mois, Uran, Mollos, Dardan, Libur, Taulant, Luan, Dragan, Gjolekë, Fatos, Fatmir, Gurro, Petrit, Ilir, Shkëlqim, Idlir, Dritan, Toskan, Mirash, Marash, Akeron, Komnen, Kushtrim, etj., etj.

Për vajza:

Teftë, Vojsavë, Fatlume, Fatoshe, Floreshë, Dodonë, Minushe, Afërditë, Djellushe, Dritë, Liri, Bukuri, Jetë, Verë, Pranverë, Trëndafile, Dafinë, Lulevere, Shkëndi, Minervë, Dianë, Dallëndyshe, Vitore, etj., etj.

Ai vlerëson veprën e Naimit për rolin që luajti në krijimin e gjuhës letrare dhe të përparimit të shkollës shqipe. Në qoftë se gjuha greke pati një Homer, gjuha italiane pati si shembull një Dante, gjuha angleze pati një Shekspir, gjuha franceze pati një Volter dhe Hygo, kurse Naimi ynë nuk e pati këtë përvojë, por ai e nisi nga hiçi dhe puna e tij është aq e pakrahasueshme, sa, jo vetëm gjuhën shqipe e skaliti, por edhe gjuhës perse i bëri një gramatikë dhe i këndoi me "Ëndërrimet", që edhe sot mbahet e vlerësohet si një nga librat poetikë më me vlerë.

Kjo e frymëzoi në rrugën dhe veprën e tij Baba Ali Tomorrin që të shkruajë poezi e këngë, të mbledhë folklor për patriotët Ismail Qemalin, Çerçiz Topullin, të krijojë nefese e gazelle, të mbledhë dhe krijojë aforizma, të përkthejë një mori poezi me tematikë atdhetare e bektashiane, duke i botuar ato. Por ka lënë një mori dorëshkrimesh, që me ekzekutimin e tij nuk dihet se ku u zhdukën. Nga Baba Ali Tomorri ka mbetur fjalimi që ka mbajtur mbi varrin e heroit Avni Rustemi:

"...Fli i qetë, Avni! Prehu i qetë në gjirin e kësaj Vlore kreshnike, pranë Ismail Qemalit të ndjerë, pranë Lekës, pranë Piros, pranë Kastriotit, pranë Vaso Pashës, Joan Vretos, pranë regjimentit apostolik dëshmorësh të Rilindjes Shqiptare."

"Politika", (Vlorë), 8 maj 1924, f.5

Kurt erdhën eshtrat e Naim Frashërit nga Stambolli e u varrosën në këtë Kryegjyshatë, në qershorin e 1937-ës, Baba Ali Tomorri iu drejtua Naimit:

"Apostull i vërtetë Naim Frashëri!

Apostull me të vërtetë që nuk u gënjye për shpresat që ushqeu, nuk na gënjeu me paralajmërimet që na bëri. Duke u ndezur e duke u tretur si qiriri, ay na mbushi zemrat me dritën e vetënjohjes, dhe me atë dritë na çeli sytë që pamë dhe na ndriti mendjet që kuptuam se s'ka kurrgjë në këtë botë për të na përçarë nga togu i shtrënguar i vllazërimit.

Ndoshta na pa në fera dhe besime të ndryshme, por na dha të kuptojmë se fetë dhe besimet, duke u predikuar me origjinalitet hyjnor, na bashkojnë përjetë dhe asnjëherë nuk na përçajnë..."

"Drita", 4 qershor 1937, f.3

Jeta e tij bektashiane nuk u nda asnjëherë nga fatet e popullit të vet. Ai mori gjallërisht pjesë në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare, duke u zgjedhur anëtar i KNÇ për qarkun e Beratit, duke bashkëpunuar ngushtë me figurat e shquara si Kahreman Ylli, Mestan Ujaniku, Zylyftar Veleshnja, etj.

Për kontributin e tij letrar e shkencor që me krijimin e Lidhjes së Shkrimtarëve më 25 tetor 1945 ai zgjidhet në kryesinë e parë të lidhjes, që kishte për kryetar, njeriun e ditur, më të kulturuarin e kohës, Sefulla Malëshovën. Në atë lidhje bënin pjesë figurat e shquara si Aleksandër Xhuvani, Skënder Luarasi, Ymer Dishnica, Lasgush Poradeci, Patër Anton Harapi, Dhimitër Pasko, Dhimitër Shuteriqi, e sa e sa pena të tjera, por edhe vepra e Baba Ali Tomorrit qendron e barabartë midis të barabartëve. Ai gjithmonë është duke punuar, duke studiuar dhe krijuar. Interersante është edhe një copëz letër që I dërgon Mit'hat Frashërit nga mali i Tomorrit.

"Tomor më 18.5.1933
Të shkëlqyeshmit Zotni,
Mid'hat Bej Frashëri
Tiranë

I nderuari im!

Me kënaqësinë më të mirë po vij t'ju çfaq falënderimet, për gjestin bujar me mundimin që muarrt për ardhjen e librave frëngjisht, të porositura tashmë nga ana ime.

Simbas listës, po ju impostoj dhjetë franga ar dhe pak lekë që mbetën, kam me ja dërgue ma vonë.

Për vonesën me padashjen tonë, lutemi të na falni.

Me këtë rast, ju bëjmë lutje nxehtësisht, të na dërgoni ndonjë katalog të librave më të ra turqisht, dhe të na rekomandoni ndonjë enciklopedi, e cila të ketë shpirtin e "Konsul alamit..."

(AQSh, Fondi 35, dosja 133, fleta 136.)

Por pas gjithë kësaj pune dhe kontributi për Baba Ali Tomorin dhe shumë patriotë intelektualë erdhën ditët më të zeza, burgosje, pushkatim, nën akuzat më monstruoze, më të padëgjuara.Pikërisht më 14 dhjetor 1948, si para tre ditësh, 70 vjet më parë, në Gjirokastër pushkatohen në të njëjtën ditë, Zenel Shehu, djali i babait të teqesë, sh komandant batalioni partizan.

Po atë ditë pushkatohen Gjyshi i Gjirokastrës, Baba Ali Tomori dhe Baba Shefqet Gllava, me akuzën agjent të anglezëve.

Ta zëmë për një moment se paskan qenë agjentë të anglezëve, po çfarë dëmi i bënë këtij populli e këtij vendi, që vranë e që prenë këta baballarë, çfarë vepre hodhën në erë e dëmtuan shtetin dhe ekonominë shqiptare?

Asgjë nuk del. Kështu, dita e 14 janarit 1948 është një ditë morti, nga më të dhimbshmet, ku njerëzit e dijes, njerëzit që tërë jetën kanë përhapur mirësi dhe dituri, pushkatohen.

Një thënie e urtë thotë se një vend që vret poetët, do ta ketë ndërgjegjen e lënduar. E rëndë dhe e pazëvendësueshme është edhe jeta dhe vepra e Baba Ali Tomorit, i cli të vetmin amanet që la ishte "Më ruani dorëshkrimet!" Dhe ne me aq sa mundemi, po e bëjmë këtë akt mirënjohje për të.

Po dikush mund të pyesë si arrita të njihem me jetën e veprën e Baba Ali Tomorit?

Dy rrugë kanë qenë: E para, duke u marrë me studimin e botimin për jetën e dëshmorëve, e më konkretisht, me jetën e Margarita e Kristaq Tutulanit, këtu e dyzetë vjet më parë, gjej midis botimeve të kohës një poezi kushtuar dy dëshmorëve beratas me nënshkrimin Gjysh Ali Gjirokastra, shkruar në shtator 1943, botuar në revistën bektashiane "Djersa" të vitit 1945.

Poezia është një elegji e dhmbshme, që për ta vajton edhe Osumi, edhe mali i Tomorrit, edhe Shpiragu.

Ç'ke që qan o Xha-Osumi?
Pse po shkon duke rënkuar?
Duke qarë po shkon lumi
Lum i zi e i sterruar?
Shkon Osumi valë-valë
I derth lotët palë-palë.
Shkon në det i pezmatuar;
Gjak i kuq i trumbulluar!
-Kesha çupë edhe djalë
Që i polla e i rrita
Nuk e di se ku m'u ndalë –
Është Kristaqi e Margarita.
Thot Osumi valë-valë
Dhe rënkon me mijëra fjalë
Ngashërohet si carua
Aan me lot për dy lastarë
Motr' e vëlla njëzetëvjeçarë.

Shtator 1943, Gjysh Ali Gjirokastra, (Ish Baba Ali Tomori)

Ndërsa për Konferencën e Pezës shkruan:

Ra borija! Ra kushtrimi! Ç'është vallë?
jepet lajmi për të vdekur dhe të gjallë!
po zjen toka shqipëtare: rra kushtrimi!
le ta marrij vesh Europa dhe njerzimi.
Se shqiptarët djem e pleq, me gra e burra
rrobërinë s'e durojnë, s'bëhen ura
bëjnë forra, rrokin armët, mbushin brezë
turren gjithë, nisen gjithë për në Pezë!
Nisen gjithë për në Pezë, kuvendojnë
për lirinë djem e çupa të lëftojnë
për lirinë besa-besë të përpiqen,
tradhëtorë e armiq këtej të hiqen.
Po! në Pezë gjith' u mblodhën, kuvenduan
lidhën fjalë dhe për luftë besatuan
besdatuan për një luftë madhështiore
ngjallnë shpirtrat dhe zakonet arbërore.
Ra kushtrimi! U bë lufta plot çudira
u derth gjaku i armiqve me rrëpira,
u derth gjaku i dëshmorëve si rrëkeja
mbi fashizmin dhe nazizmin ra rrufeja.

Gjysh Ali Gjirokastra. Djersa, nr. 2, shtator 1945, Tiranë, f. 7

Vonë-vonë mësova se kush ishte autori. Po kështu, duke u marrë para mëse 20 vjetësh me veprën e Naimit, në shtypin e kohës gjej rreth 12 shkrime kushtuar kryesisht poezive të "Luleve të Verës". Shkrimet i kishte bërë më një penë vërtetë të një niveli të lartë, jo vetëm si vlerë artistike, por edhe me nivel të lartë filozofik.

U befasova dhe më rrëmbeu puna e këtij njeriu krejt të panjohur, që për Naimin kanë bërë monografi të plotë si prof. Shuteriqi, prof. Qosja e shumë të tjerë, por kurrkund nuk i janë referuar.

Kjo më trishtonte, por dhimbjen dhe trishtimin ma shtoi kur mësova për fundin tragjik të tij. Kjo më shtyti q ë krahas studimit dhe botimit të veprës së Naimit, Kristaq dhe Margarita Tutulanit, duke gërmuar nëpër arkiva, nëpër biblioteka, duke shfletuar botimet dhe shtypin e kohës, tani kemi plot pesë vëllime me krijimtari të Baba Ali Tomorrit, e cila qendron e barabartë midis shoqeve të veta.

Na del detyrë që këtë krijimtari ta bëjmë pjesë të kulturës dhe pasuri të popullit.

Kam besim se nën kujdesin e veçantë dhe përkushtimin e tij të shenjtëruar, të Kryegjyshit Botëror Baba Edmond Brahimi, sot duke kujtuar edhe meritën e madhe të Baba Reshat Bardhit që e ringritën fenë bektashiane dhe institucionet e saj, duke i nisur nga hiçi, sot kemi edhe këtë panteon që përveç të tjerave ka dhe bibliotekën e vet, ku do të ketë vendin e vet të nderuar edhe vepra e papërsëritshme e Baba Ali Tomorit.

Sot është 17 janari, është edhe 550 vjetori i Gjergj Kastrioti Skënderbeut. Për të këndoi 120 vjet më parë Naimi, po 120 vjet më parë botoi "Qerbelanë", që është testamenti i Naimit. Po këtë vit kemi 130 vjetorin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Poi sivjet kemi 110 vjetorin e Kongresit të Manastirit për Alfabetin Shqip.

Kemi përpara ngjarje të mëdha. Në gjithë këto ngjarje intelektualët bektashinj kanë kontributin e tyre, kanë lënë gjurmë me veprën e tyre. Nuk është e rastit që Teqeja e parë bektashiane ngrihet në Krujën e Skënderbeut. Në Frashërin e Përmetit të Abdylit, Naimit e Samiut u hodh fara e u ndezën shkëndijat për t'i ndezur në Prizren, e për ta bërë këtë, Abdyl Frashëri harxhoi një barrë flori, po që të shkohej në Manastir për t'i vënë vulën përfundimtare këtij alfabeti që shkruajmë sot, ishn edhe teqetë, shkollat e para ilegale, ku u shkrua dhe u këndua ky alfabet.

Dhe në këto evente madhështore kanë të drejtë morale që Komuniteti Bektashian ka se çfarë të thotë dhe të tregojë.

Ju faleminderit që më dëgjuat, dhe falenderoj edhe një herë Kryegjy- shin Botëror Edmond Brahimaj për mundësinë që ma krijoi që t'i themi dy fjalë zemre për këta martirë që balta shqiptare t'u jetë më e ëmbël se mjalta, atje ku ende i ruan me dhembshurinë e dashurinë e nënës Shqipëri.

Tiranë, 16.01.2018

DUKE MOS E PRITUR GODONË

Cikël poetik nga Ahmet Selmani

TESTAMENTI I TEUTËS
(ose mbretëresha e pikëllimit)

Unë jam
mbretëresha e pikëllimit
që pas vetes
po i lë dy gjëra
si një testament të pashkruar
nëpër ajër
po e lë
mbretërinë e pabërë
dhe dashurinë time të dështuar
le të bredhin
si dy zogj të trishtë
ndoshta në krahët e tyre
do ta shihni hartën e Ilirisë
dhe zjarrin e dashurisë
së një gruaje.

GJUMI NË SHTRATIN E PROKRUSTIT
(ose zgjimi me këmbë të shkurtuara)

Nata e futi në kurth
dhe ra të flinte në Shtratin e Prokrustit
por në mëngjes kur u zgjua nga gjumi
e pa që s'ishte në kthinën e vet
këmbët ia kishin shkurtuar
e nga pikëllimi deshi të ikte
po tani hapat i kish të vegjël
dhe nuk e dëgjonin
si më parë.

SALVA NOS, PERIMUS
(ose lutja e Pjetër Bogdanit)

Salva nos, perimus*
lutet Pjetër Bogdani
me gjuhën e dhembjes
nga e cila pikëllohet edhe ajri
shkërmoqen edhe gurët
dhe toka i shkul flokët
Salva nos, perimus*
atje kafshon koha në gurmaz
rikryqëzohet Krishti çdo ditë
dhe askush nuk qan
engjëjt e Abrahamit rropen tinëzisht
dhe askush nuk i sheh
Salva nos, perimus*
Shkupi ka mall për një meshë
në gjuhën e vendit
gati po mbetet pa gojë
sheh vetëm ëndrra prej varri
thith hirin e vet për të jetuar
Salva nos, perimus*
atje shpresat ecin udhëve pa krye
dhe kthehen si kufoma të gjalla
ne emër të jetës qëndrojnë në këmbë
dhe qeshin ngaqë s'mund të qajnë
Salva nos, perimus*
ne s'kemi ku të shkojmë më larg
se përtej vdekjes pa një varr
ne s'kemi ku të shkojmë më larg
se përtej harresës
ne s'kemi ku të shkojmë më larg
se përtej zhbërjes para syve të hyjit
Salva nos, perimus!

* Salva nos, perimus (Na shpëto, se mbaruam! – kështu u lut kryeipeshkvi i Shkupit para papës në Vatikan)

RRNO VETËM PËR ME TREGUE
(ose pëshpëritja e atë Zef Pllumit)

O atë i përvuajtur
më shumë se Krishti i gozhduar
ti e njeh më mirë se çdokush tjetër
kryqin e territ
të ngulur në mish të gjallë
por edhe bukurinë e pashoqe
të dritës
që vdes në sytë e verbër
të njeriut
ti vjen me hijen tënde
të mëndafshtë
në kthinat e ëndrrave të mia
dhe më pëshpërit
rrno vetëm për me tregue
deri ku mund të shtrihen kufijtë e marrëzisë
deri ku mund të tkurret atdheu gjysmak
deri ku mund të durohet poshtërimi
deri ku mund të bëhet turpi si buka
deri ku mund të arrijë tradhtia
o atë
me rrudha engjëlli në ballë
ka kohë që unë nuk e di më
nëse qaj apo qesh
por ti më vjen shpesh me këmbë drite
dhe më pëshpërit
rrno vetëm për me tregue
o bir i mirë i dheut të ashpër
se një ditë dikush do të mësojë
nga gabimet që kemi bërë
e do të ulet në krye të vendit
me mendje të ftohtë e këmbë të nxehta
me na e trandë kujtesën e ngrirë
si degët e pemëve nga bora e acartë
e me çelë si luledielli
o atë i urtë
përnjëmend ia vlen
të rrnoj vetëm për me tregue
amin

MALLI PËR FJALËN EMBETHA
(ose bajlozët e hëngrën atdheun)

Embetha*
sa më ka marrë malli
ta dëgjoj këtë fjalë
nuk e di pse aq shumë
e kanë mbuluar me harresë
nuk e kanë futur
as në fjalor

embetha
është fjalë e vjetër
që i shkon edhe kohës së re
kërkon një gojë të zjarrtë
që ta shkrepë si rrufe
dhe një shpirt të pastër
që t'i japë jetë

embetha
s'mund të duroj më
se bajlozët
e hëngrën të gjallë
atdheun
embetha

* Embetha – Mbi ta! (suluni mbi ta, bjeruni). Fjalë që na e sjell prifti shqiptar nga Drishti, Dhimitër Frangu (1443-1525)

DUKE MOS E PRITUR GODONË
(ose gjërat e bëra me duart e mia)

Unë
do bëj gjëra të pabëra
duke mos e pritur Godonë
gjersa të vijë nga pafundësia e kohës
e të na shpëtojë nga rrethi vicioz
ku e kërcejmë vallen e absurdit
si minj të dehur
gjithçka do ta bëj vetë
si engjëll rebel që ik nga duart e zotit
pa ia ditur as për blasfemi
e as për herezi
do bëj gjëra të pabesueshme
ensëh daashunit sëh botësë sanëh
aq sa di
dhe aq sa mundem
por me Godonë s'dua të takohem kurrë
as ta njoh
si qenie të gjithësisë
e lërë më ta përshëndes
apo t'i duartrokas me turmën
Godoja
është vetëm emër me fytyrë gogoli
që zgërdhihet pas shpine
është perëndi
e krijuar nga njerëzit me tru laraske
është yll i zi
që ushqehet me gjakun e natës
është Shën Pjetër i tradhur
që të lë në baltën e ngrirë
e s'të nxjerr kurrë
kam një mijë e një arsye
të mos e pres Godonë
të vijë me kalin e rremendjes
e të zbresë si qenie prej ajri
a prej pluhuri
ndaj do bëj shumë gjëra të vogla
me të cilat mund ta bëj një botë e madhe
duke mos e pritur Godonë
as në gjumë
e as në ëndërr
Godoja aq e pëshpëritur
edhe nëse vjen njëditëzaj
do të plasë nga pikëllimi
kur t'i shohë gjërat e bëra
me duart e mia.

TRINIA E ZEZË
(ose shitja e atdheut)

Në emër
të djallit e birit e shpirtit
të shitur
për ta shpëtuar lëkurën
nga rreziku
po ia shes armikut një copë
të atdheut

PUTHJA E TRETË QË MUND TË FUTET NË ROMAN

pjesë nga një roman në dorëshkrim

Andreas Dushi

Jam shumë i sigurt se rrugës u takova me një Mjeshtër. Në fillim ia lashë lodhjes së madhe, por mandej u binda se kështu kishte ndodhur vërtetë. Besoj, atëherë kur ndala makinën për të marrë një sy gjumë. Është, ndoshta, i vetmi njeri të cilit, qysh prej shumë kohësh i kam thënë gjëra me mend.

"A e di çfarë është gabimi?" - më pyeti i menduar, duke tërhequr poshtë mjekrën e stërgjatë prej bredhi kokërrënë.

"Po," - i thashë. E mendova, jo pa pendesë të fortë më pas, një këngë që ime më ma këndonte kur akoma e dëgjoja:

"*Autobuzi shkon kudo*
Emrin tim e mban mbi shpinë
Kjo Mirela thotë kushdo
Paska bërë sot një gabim."

Apo mos ndoshta është "*ja Mirela*", jo "*kjo Mirela*"? Nuk e di.

"E ç'është pra?" - më pyeti.

Tejet *chliché*, apo jo? Të shkruash në një libër për gabimin. Dhe atë pendesën që e ndjek. Nuk ia vlen aq shumë ë? Si thua?

"Po ja, gabimi është kur nuk vepron si duhet."- i thashë. E çka mund të shtoja më tepër?

"Ma thuaj një gabim!" - sikur më urdhëroi Mjeshtri. Aty e mora vesh edhe se ai ishte Mjeshtër, sepse e pyeta - "E pse?" "Unë jam Mjeshtër." - m'u përgjigj. Mjeshtër i kujt..., por s'e vazhdova.

Tani po që do t'i përngjaj shkrimtarit *pis*. Por kjo është e vërteta: atëbotë veç ky gabim m'u kujtua:

"Pas gjithë asaj kohe, ndjeva ngrohtësinë e të pasunit pranë vetes një trup tjetër. Sikur bulëzat e lëkurës së saj nxirrnin një lloj afshi të vakët për të hyrë drejt e brenda simotrave në timen. Ishte njeriu i vetëm që, pas kushedi sa vjetësh (jo aq shumë si numër, por si dendësi) më bëri një dhuratë, dhuratë të vërtetë, të mirëmenduar, me kuptim e vlerë.

E gjitha ishte shumë, shumë e bukur që të zgjaste më shumë nga sa pulitja e syve merr kohë. Një javë a pak më vonë, dola me dikë tjetër. Njiheshim prej kohësh, si miq e kolegë. Hera e dytë që dilja vetëm me të. E dyta!

Pimë shumë, më shumë nga sa duhej, - e kush e di se sa duhet? - dhe rrugës për në kthim, më puthi. E putha edhe unë, me pasion e forcë, dhimbje e bindje, mbështetur e gjitha në sigurinë se nesër, po të mos isha duke vepruar drejt, do ia lija pijes. Të dy pohonim se po bënim gabim, e dinim se po bënim gabim, por prap putheshim. Po puthesha me atë që veç një herë i kisha dhënë dorën pasi ruanim gjithmonë një lloj largësie, të imponuar prej saj. Veç një!

Natyra ime e mbrapshtë s'më lejoi mos ta bëja pyetjen më të pavend në të tilla raste: 'Çfarë të shtyu të më puthje?'

'Kam parë një ëndërr sikur putheshim dhe ishte fantastike!' -më the ti. Dhe erdhe e më puthe prapë.

Buzët e tua të holla, nga të miat, të fryra porsi tullumbacëza, u gllabëruan. Desh', për një çast mendova mos i hëngra, sikur u bënë një me to, pjesë tyrja.

Mandej ne u ndamë dhe ti ike në shtëpi, unë u struka në një taksi, gjithashtu për në shtëpi. Isha pa arritur kur ti më shkrove. T'u përgjigja sikur kisha arritur. Ma shkrove gabim emrin. Edhe unë ashtu ta shkrova ty. Si një lloj marrëveshjeje për të krijuar dy personazhe që buronin në ne, por jetonin në realitetin paralel ku s'besoja se arrihej përveçse mbyllur brenda kapsulës së pijes. E kisha gabim!

Kur çela derën, të shkrova prapë. Ti s'më ktheve..."

"Pse më drejtohesh mua?" - pyeti Mjeshtri.

"Vërtetë mendon se nuk e di që je Ti?"

"Nga e di?"

"Është e thjeshtë. E ke nxjerrë veten nga vetja, e ke shtjerë në një mace duke u bërë shpirti i saj i tetë, sepse e dije që aty s'do të kishte vend. Ajo ka lëvizur, e tërbuar, të vritet e ta humbasë njërin, të të humbasë ty. Dhe ti ke dalë kur atë e shtypi këmba e stërmadhe e Mjeshtrit. Hyre brenda tij, e vrave dhe i zure vendin e lënë bosh, porsi gërdallë nga shpirti tanimë i ngordhur."

"Prapë, nga e di ti?"

"Pasi të ka nxjerrë ty prej vetes, ajo mace ka ngrënë një zog që jeton në shpatullën e një burri që gjithashtu e takova gjatë rrugës. Zogu i ka thënë se veç po jetoi ai, jeton edhe burri. Por maces së pamëshirshme sikurse janë macet, aq i ka bërë. E ka kapërdirë ashtu, një cope, pa e përtypur. Dhe brenda, ai ka takuar shpirtrat e tjerë të saj. Ata ia thanë historinë, e ai ma tha mua. Kam të drejtë, apo jo?"

"Po,"- tha. "Pra, ky është gabimi?"

"Jo. Kjo është pjesa e parë, si të thuash paranteza e gabimit. E di kur ndodhi gabimi? S'ke nga..."- por më ndërpreu.

"Unë di gjithçka."

"E nga di ti gjithçka?"

"Edhe shpirtrat e tjerë të maces, njerëz janë."

"Pra, e di gabimin?"

"Jo, por diçka kam dëgjuar. Gjithsesi, dua ta dëgjoj të plotë nga ty."

"Dakord Mjeshtër!"- shqiptova me një dozë të lehtë ironie. Ajo e vuri re, por thjeshtë veshi cepin e buzës me pëlhurën e dëbortë të buzëqeshjes.

"Kur hyra në shtëpi, telefonova vajzën që i dilte ajër i valët nga poret. Dhe i thashë se nuk mund të ishim bashkë. Ajo qau, shumë, më telefonoi pafund, e herën e fundit kur folëm, më kërkoi ta bllokoja. S'e bëra, por fika celularin. Dhe fjeta, pa menduar se si ajo do ta përjetonte. Në mëngjes pashë se më kishte telefonuar trembëdhjetë herë, shto kësaj edhe gjashtë herët që kishim folur, nëntëmbëdhjetë herë. Kushedi sa mesazhe. Në të fundit rrëfente se kishte qenë te shtëpia ime, por s'e kish' gjetur guximin të trokiste, ndaj qe larguar.

Më tha, çka e dija edhe po mos të ma thoshte, se jam i papjekur, i dobët, e të tjera si këto. Dakord, i thashë, ke të drejtë. Jo për t'i dhënë fund bisedës, por ngase vërtetë besoj se kishte të drejtë.

Sipas saj, ne do të ishim një dyshe shumë e mirë, shumë e bukur, shumë e këndshme e ku ta di unë. Dhe unë, jo pse jam një njeri i mirë, përkundrazi, por e dija se as me ty s'do të krijoja dot diçka. Ama s'mund të kisha një të dashur përtej së cilës, do të puthja gjithmonë çdo vajzë që do të më ndillte.

Kur u qetësova, kuptova se shqetësimi im qe i kotë. Ti nuk ishe 'çdo vajzë që më ndillte'. Ti ishe ajo që, ëndërroja të të prekja, jo më të të puthja. Dhe një të tillë vajzë e dija se s'do të më ndodhte ta takoja sërish. Ndaj, s'është se do të kisha kë të puthja, edhe po të doja. Por gjithsesi, më mirë që e gjitha mbaroi atëherë me të. Edhe pse, kur them më mirë, sikur nuk i ngjan një gabimi, apo jo?"

Veç atëherë vura re se po i flisja me sytë e ulur përdhe. I ngrita, ta shihja. Mjeshtri po zbërdhulej, mes një trajte të tymtë e të butë si pezhishkë merimange, krejt e ngjashme me mëngjesin e asaj dite.

Fërkova me forcë sytë të cilëve as nuk mendoja t'u besoja. Kur i hapa, pashë se shpirti yt pati hyrë sërish në trupin tënd. Ti ece pak çapa, lehtë e lehtë pranë meje dhe më puthe, fort. Sërish i ndjeva buzët tua të bëheshin pjesë e të miave, sikur aty të përkisnin e ishin shkëputur për pak kohë, për t'u rikthyer prapë. Ai çast qe rikthimi i pritur, gëzimi i madh. Dhe ai çast qe gjithashtu universi ku ndodhi puthja jonë e dytë.

Mund të mbyllet një univers në një çast?

"Po!"

Nuk po flas, po shkruaj! Ku je që më lexon e përgjigjesh vetë?

"Këtu, pranë teje, ulur krejt ngjitur me ty."

"E pse nuk të shoh?"

"Kafsho buzën e poshtme, aty është pjesa e buzës sime brenda tëndes."

E bëra.

"Kjo ishte puthja jonë e tretë!"

LIDHUR PAS HËNE

Cikël poetik nga Nurie Emrullai

Orfeut tim

U harxhua ëndrra ime
si një çamçakëz i tejpërtypur,
që ia harron shijen e parë.

S'e di çfarë më mban akoma këtu,
sa kohë do të rrinë çelur portat e mishit për mua?
Më vjen të teshtij,
por kjo s'lejohet në ëndrra dhe varrime,
ndryshe duhet të gris mbathjet e trupit tim.

Ti më shfaqesh përtej rruge,
dhe unë atëherë kujtohem,
se ëndrrat kanë mesazhe.
unë afrohem të të prek dorën,
ti këtë herë shikomë!
Orfeu im, hapi sytë këtë jetë
dhe kundroje shpirtin tënd,
jam e bërë për ty,
prej dëshirash e gjaku,
prej pritjesh e mishi,
jam e bërë në ditë dhe shekuj,
jam gati të hidhem zjarreve për ty,
jam shumë gati...
të ha hirin e eshtrave të mia për ty.

Ti përtypesh,
dashurinë e mbledh topth,
e pështyn rrugëve,
një pëllumb gënjehet pas tij,
e provon ta hajë dhe mbytet.
Dikush më shkund nga krahët
dhe më zgjon të bëhem gati
për një ditë të re.

Udhëtar

Më çoni atje,
ku perënditë janë në paqe me veten.

Ku mbrëmja nuk është aq e dhimbshme,
sa veç për të fjetur.

Më çoni atje,
ku buka hahet prej dëshire,
jo veç prej mungesës së gjithçkaje tjetër.

Të shkoj atje,
ku gjallë akoma është dashuria,
dhe veç prej saj çelin frutet,
e jo nga frika mos vjeshtohen degët vetëm.

Më çoni atje
ku njerëzit japin ditës dritë dhe
shpirtin e ndjejnë gjallë brenda tyre.

Më çoni atje,
ku perënditë janë në paqe me veten.

Dhe t'u rrëfej numërimin e viteve tona...

Lidhur pas hëne

Hëna m'ka lidh pas saj…
Unë si e çmendur
kërkoj të më lëshojë...
– Më lësho! - bërtas
– Nuk të dua!
Kurrë s'kam dashur në jetë.
Veç njëherë!
Atëherë thanë se isha fëmijë
(ku merrja vesh nga dashuria?!)

Mos ndriço dhe ti!

Lërmë të zhytem në thellësinë e natës...
S'të dua as ty, as botën,
në jetë veç një herë më kanë dashur
(dhe nuk e mbaj mend)
atëherë isha fëmijë...

Hëna m'ka lidh pas saj..
Unë si e çmendur
kërkoj të më lëshojë...

X

Të kam blerë një ëndërr
në pazarin e Esmës.
Ajo ma dha lirë
e më premtoi se është e bukur.

Në pazarin e vjetërsinave,
mes krevateve të braktisur prej lëkure të vërtetë,
karrigeve pa tavolina
dhe ca byzylykë të këputur,
që mbajnë erën e dikujt që s'e njohim,
mes atyre gjërash,
gjeta këtë ëndërr t'harruar.
Esma ma premtoi se:
Ajo qenka e paëndërruar më parë,
pastaj si të thuash,
pas një pazari të gjatë...
Ajo ma shiti aq lirë, sa ma fali!

Tani merre
sepse unë nuk di ç't'i bëj,
s'do të mbahet në duart e mia,
shpirtin më ka ngrënë gjatë gjithë rrugës.
Duket, vendet e braktisura nuk i do.

Merre, tani është e jotja!
Provoje a të nxen?

Limontisje

Nuk mëtoj më të vjedh prej ditëve të mia e t'ia fal mungesës tënde,
edhe durimi pas një kohe limontohet.

Nuk mëtoj më të jem e verbër, vetëm se s'dua të shoh mospërfilljen tënde.
Kërkoj e shtirem se s'di ç'kërkoj,
e krejt kjo vjen se ti nuk je.

Tani jam gjysmë mendje e gjysmë zemër,
teksa tërheq shpirtin tim herë në një anë, e herë në anën tjetër.
Vetëm për të lëvizur kohën e panumëruar, ditët në trajktoren time...
A e di se sa vite mbas kam mbetur?

Nuk mëtoj më t'ia vjedh ditët jetës sime,
nuk mundem ta lë zemrën mbi duar që duken e tërhiqen.
Mos iu frikëso rritjes

Unë dhe ti nuk flasim gjuhën e njëjtë,
Lëvizjet e trupave tanë tregojnë se jemi harruar, mu kur betoheshim!
U dimëruam gjer në palcën e mbrame të ashtit,
koha e bluajti me dhëmbët e egër të dyshimit.
Por, i mbijetuam rritjes.
Sa stinë kaluan nëpër rrudhat tona?!
Dhëmbët tanë kërcëllohen nga premtimet e ngrëna,
Këmbët plaken nga ikjet e mendjes.
Po jetës i shpëtuam?
Po shpirti ku është tani?
S'ka pse të të vijë turp,
shpirt s'kemi më. A nuk ke dhe t'i të ftohtë?
Ishim të tjerë kur qeshnim,
krejt të tjerë kur gjuhëmjaltëzoheshim.
Tani që hamë njëri-tjetrin me fjalë,
trupëzohemi, trungjëzohemi.
Mos u frikëso:
Urrejtjen dhe dashurinë gjuha di t'i ndajë.
Këtë e kuptova unë që u ngjita flakëve,
unë që në zjarrin tim veten shkrumbova.

Pritja

Më thuaj cila pritje
e ka bërë njeriun të buzëqeshë
e t'ia gëzojë shpirtin?

Më thuaj cila pritje
s'ka hapur varre nëpër kujtesë
për t'i mbushur ata me ëndrra t'lëna në gjysëm?
më thua dot?

Cila pritje nuk ngjan me orën e kurdisur
që të zgjon të bëhesh gati, e ti s'din për ku?

Cila pritje nuk t'ka mbajtur me kokën ngjeshur në orë,
e ora vërtetë s'ka pasur rëndësi.

Cila pritje nuk t'ka çuar të shohësh kalendarin
Të çdo nate që lind diell të ri.

Cila pritje nuk ka ngjarë në krakëllimë korbi
i mbështetur në degë të pritjes,
në pritje t'ia nisi këngës, mbase...

Ma thuaj cila pritje
t'ka bërë të besosh në premtime
që s'kanë qenë veç dalldisje çasti.

E ty të them që pritja
është më e fortë se harrimi...

Po cila pritje e ka bërë njeriun të buzëqeshë
e prap' ta lë të harrojë.

Do të ik

Duhet të ik. Kjo është e pashmangshme.
Prita se dikush do më kërkonte.
Asgjë s'erdhi në jetën time të lëmuar dhe shkëlqyese si teh thike.

Ndryshova veten gjer në rrënjë.
S'ma kërkoi kurrë asnjë. Sa e dhimbshme!
E ndryshimi i rrënjve than gjethet.
S'ka më as filiza. S'ka më as pranvera.
S'ka zogj që vinë dritares sime;
unë vrisja vetminë, ata donin bukën time. S'ka më as bukë.

Ngulmoja se dikush do ta sjellë çelsin e burgut tim.
Dikush do të ma ndërrojë racionin e ushqimit në mendim.
Dikush a diçka do jetë e vetmja ndodhi e imja. E unë do kem më n'fund diçka.

Sa e gabuar, të mos dallosh Do të pres dhe Të pres.

Një karrocë po ma ndal mendimin.
Vrapon kali sikur i digjen këmbët në zjarrin e ferrit.
Heshtje e ftohtë na zuri të dyve si bora mbi shpinë varfënjaku.

Jo, jo, duhet të iki. Kjo është e pashmangshme.
Në fund të fundit është rruga ime.

Karroca u ndal. Njeri mbi të s'kishte.

Ferri është vend i heshtur

Ne digjemi mes zjarresh,
këtu është një vjeshtë që plak secilin shëmtueshëm,
si me qenë gjethe që digjemi nga bryma.
Është një zjarr për të cilin s'flitet,
e s'i kujtoj dot piskamat e këtyre djegieve,
se ferri është vend i heshtur.

Ja zjarri
që e mbajmë ndezur,
fry e fry që ta silisim,
që mëkatet me heshtje t'i djegim.

Të pathënat e një jete

Në kohën që po jetoj,
ajo çka më pak dua është trishtimi yt.
Andaj unë po ik i dashur,
për të të lënë me përgjigjet e pakta që i ke mbi botën,
e ty fatmirësisht të mjaftojnë.

Po ik për të të lënë me frikën tënde,
të jesh i lirë prej dashurie,
të njohësh njerëz të tjerë,
e t'i duash dhe ata veç për një ditë,
siç më doje mua...

Ajo çka u rrit bashkë me ne,
në ty ishte frika, në mua fjalët e pathëna,
që s'patën vend e kohë për të t'i thënë më.

E çka nëse të thoja se të dua?
Nata përsëri do të vinte pa hënë,
në ty përsëri frika do të ishte më e fortë se dashuria.

Prej njerëzve mësova se ata jetojnë me frikën
e të dashuruarit marrëzisht,
frikën e të puthurit siç puth Uliksi tokën e vet,
siç puthi për herën e fundit Kalipso Odisenë…

Prandaj sonte është nata e fundit
që i shoh yjet nga kjo anë
e në ata kudo shikoj fytyrën tënde.
Kam për t'u kthyer në hije si kjo natë sonte,
aq e heshtur do të bëhem, njëjtë sikur erdha...

SUPERMENI, HERKULI DHE BINDËSIT E OPINIONIT

Supermeni është një personazh i trilluar imagjinar amerikan, një superhero i cili fillimisht është publikuar nëpër libra komikë nga kompania amerikane "DC Comics". Shkrimtari Jerry Siegel dhe artisti Joe Shuster e krijuan atë në Cleveland, Ohio në vitin 1933. Me shumë interes është pritja masive që publiku i bëri Supermenit. Kjo përkon me dëshirën sociale për të patur heronj të rij.

Sipas studiuesit italian Umberto Eco i cili përdori termin "meccanica mitopoietica" apo mekanika e krijimit të miteve, thotë se: "Në një shoqëri masive, në epokën e civilizimit industrial, procesi i mitizimit është i ngjashëm me atë të shoqërive primitive".

Ndryshe nga supermeni, një figure mitike e lashtësisë, është dhe Herakliu. Emri Herakli ka prejardhje nga greqishtja e lashte dhe është kombinim i emrit Hera (gruaja e Zeusit) e cila e përndiqte dhe Kleos (që do të thotë lavdi). Shpesh e ndeshim me emrin latin si Herkuli. Herakliu ishte i biri i Zeusit me Alkmenen. Si bir i Zeusit ai ishte gjysëm perëndi.

Në tokë Herakliu bëri shumë të mira, ku më kryesoret njihen si dymbëdhjetë bëmat e tij. Ai ishte mjaft i fuqishëm trim, plot me virtyte por dhe me dobësi njerëzore. Pikërisht prej këtyre dobësive njerëzore ai u detyrua të vuante. Vdiq i helmuar nga lekura e Luanit që mbante të veshur, e cila iu ngjit me lekurën dhe në agoni e siper shkuli disa pemë ku u dogj bashkë me to. Ai jetoi midis njerëzve, ku lindi dhe vdiq. Pas vdekjes u ngjit ne Olimp.

Supermeni nuk është tokësor, por erdhi në tokë nga planeti Kripton, i cili po shkatërrohej nga një katastrofë kozmike. I ati i Supermenit, një shkencëtar mjaft i zoti e dërgoi atë në tokë nëpërmjet një mjeti transportues hapsinor. Supermeni u rrit në tokë me fuqi mbinjerëzore.

Ai mund të fluturojë në hapësirë me shpejtësinë e dritës, madje mund edhe ta kalojë shpejtësinë e dritës duke u kthyer pas në kohë dhe duke patur mundësi të shkojë nëpër epoka të ndryshme. Ai mund të shohë me rreze X, mund të shtrëngojë me duar një copë karbon dhe ta kthejë atë në diamant. Ai është i bukur, i mire, i përulur dhe jeta e tij i dedikohet luftës kundër së keqes, duke bashkëpunuar me policinë ideale.

Këtu mund të sugjerohet, duke qënë se Supermeni mund të udhëtojë nëpër epoka të ndryshme më shpejt se drita, të kthehet pas në kohë dhe të takojë Herakliun dhe ta shpëtojë atë nga helmimi dhe nga vdekja.

Herakliu pas vdekjes nga helmimi dhe djegia, u ngjit për të jetuar në Olimp, aty ku rrinë perënditë. Herakliu aktualisht jeton në një dimension tjetër, në atë të perëndive, të përjetshëm pas vdekjes. Herakliu mund të ndjekë nga Olimpi, nga dimensioni tjeter, historitë tokësore të Supermenit.

Në të dyja këto raste, mitizimit mund ti krijojmë hapësira të pafundme të imagjinatës. Supermeni, nga vetë përkufizimi nuk është real. Për Herakliun gjithashtu nuk kemi prova nëse ka ekzistuar realisht.

A mund të takohen ndonjëherë Supermeni dhe Herakliu, dy personazhe ku njëri nuk është real dhe tjetri nuk mund të ekzistuar? Kjo duket se nuk ndodh në këtë dimension që ne e quajme realitet.

Por ato mund të takohen në dimensione të fshehura brenda pavetëdijes. Ajo që ngelet reale nga "meccanica mitopoietica" e Umberto Ekos apo mekanika e krijimit të miteve dhe pritjes se tyre publike, këtu i shtohet analiza dhe perceptimi i pavetëdijshëm social. Supermeni u pranua nga shoqëria dhe Hekaliu gjithashtu. Ato madje u priten mjaft mirë dhe janë të famshëm për bëmat e tyre në të mirën e njerëzimit.

Në 1957 sociologu amerikan Vance Packard publikoi "Bindesit Okultë" ku ai analizoi mekanizmat që përcaktojnë konsensusin e opinionit publik, kryesisht në sajë të komunikimit televiziv dhe industrinë e reklamës. Profesionistët e komunikimit janë përshkruar nga autori si "Bindësit e fshehur", për shkak se ata përdorin teknika që tentojnë të ndikojnë konsumatorin, i cili vepron në pavetëdijen e tij.

Mundet që nëse pavetëdija kolektive që kërkon të eleminoje pasiguritë në ndjesitë e saj, nëpërmjet mitizimit të heronjve të tille, të kërkojë të rrisë sigurinë mbi të ardhmen. Loja midis përmasave irreale dhe profesionistëve të komunikimit duket se ka vazhduar të rrezistojë në kohë si mënyrë optimiste e krijimit të heronjve të rinj edhe në të ardhmen. Të paktën në këtë drejtim buzëqeshja optimiste mund ti ktheje shoqërive motivimin e luhatur ndërmjet fantazive të proceseve kreative,ku bindësit e opinionit publik, ashtu sikurse Herkuli dhe Supermeni, të vijojnë të jenë të aftë për të kryer detyrën e tyre morale.

Botim i ri nga Ombra GVG

TAO TE CHING

RRUGA DREJT VIRTYTIT



"Tao Te Ching", i quajtuar ndryshe edhe si "Laozi" është vepra e pare filozofike e plotë në historinë e Kinës antike, si dhe burimi kryesor i mendimit flozofik të Taoizmit. Megjithatë ajo është konsideruar gjithashtu edhe si një "Poezi filozofike" ose "Filozofi poetike", e cila është përmirësur vanzhdimisht ndër vite dhe që pasqyron mendimin e periudhës së Pranverë-Vjeshtës (770-476 para Krishtit).

Pavarësisht debateve dhe paqartësive lidhur me autorin e kësaj vepre, është pranuar tashmë se ajo është shkruar nga Li Er, i cili sipas legjendës, ka pasur mjekër dhe vetulla të bardha qysh në lindje, prandaj nga pasardhësit u quajt Laozi (Plaku-Plaku i urtë). Laozi ka lindur në fund të periudhës së Pranverë-Vjeshtës, pra rreth 2500 vjet përpara dhe konsiderohet si filozof, mendimtar e historian i Madh i Kinës antike, si themelues dhe përfaqësuesi kryesor i shkollës së Taoizmit. Po kështu Laozi është cilësuar si një ndër njerëzit më famshëm të kultures botërore si dhe renditet ndër 100 historianët më të famëshëm të botës. Doktrina e tij ka luajtur rol të rëndësishëm për gjithë zhvillimin e filozofisë kineze.

"Tao Te Ching" përbëhet nga dy pjesë kryesore, "Tao Ching" dhe "De Ching", ka gjithsej 81 kapituj, nga të cilët 37 kapitujt e pare flsin për Tao-n, ndërsa 44 kapitujt tjerë për Te-në. Tao është koncepti thelbësor dhe kategoria më e lartë filozofike e këtij libri, baza mbi të cilën është ngritur dhe formësuar i gjithë mendimi filozofik i Laozi. Tao, si fjalë unike, është përdorur edhe para Laozi-s, që i referohej kryesisht "rrugës", ose "arsyes" dhe kuptimve te tjera. Ndërsa Laozi për here të pare parashtroi temën e burimit të botës, duke u shprehur se "Tao" është madje më thelbësore edhe se "Qielli", dhe se "Qielli" lind nga Tao. Tao nuk është vetëm rruga e universit dhe e natyrës, por edhe rruga e kultivimit të individit me Tao-n. Ndërkohë "Tao" e aplikuar në botën reale dhe aspektin e jetës njerëzore, quhet "Te", pra "Te" është rezultat i aplikimit të Tao-s. Kurse Te nuk i referohet thjesht kuptimit të saj fillestar, moralit ose virtytit, por një botëkuptimi dhe metodologjie te veçantë për tu marrë me kultivimin e njeriut. Sipas Laozi, morali është themeli dhe Tao është lartësimi i moralit. Nëse nuk mbështeten në këtë themel, ka shumë të ngjarë që njerëzit të dështojnë në trajtimin e çështjeve botërore, në admnistrimin e familjes dhe qeverisjen e vendit, pra nuk do të jenë në gjendje të "kultivojnë moralin". Pikërisht sepse "Tao" dhe "Te" janë dy konceptet kryesorë që Laozi trajton në këtë vepër, prandaj edhe libri është titulluar "Tao Te Ching".

Ideja, subjekti kryesor i "Tao Te Ching" është se "Tao ndjek Natyrën". Duke qenë koncepti më abstrakt i këtij libri, "Tao" konsiderohet si burimi i forces lëvizëse të gjithësendeve në Tokë dhe Qiell, ndërsa "Te" si zhvillim dhe shprehje e Tao-s në fushën etike. Nga aspekti filozofik, "Tao" është mëma, zanafilla e gjithësendeve, e kundërta dhe uniteti i Yin dhe Yang është thelbi i gjithësendeve, ndërsa ligji i evolucionit të gjithësendeve nënkupton kthimin e gjërave në të kundërtën e vet, kur ato arrijnë në ekstrem.

"Tao ndjek natyrën" e shpallur nga Laozi, është i ndryshëm nga Ligji Natyrës në perëndim. Ky i fundit e ka origjinën nga tradita e liberalizmit dhe racionalizmit në Greqinë dhe Romën antike. Baza të tij janë konceptet e drejtësisë, mirësisë dhe demokracisë, të cilat janë baza natyrore për vlerësimin e ligjit pozitiv ose ligjit njerëzot. Ndërkohë mendimi i Laozi "Tao ndjek natyrën" bazohet në origjinën e gjithësendeve, që do të thotë se "Tao" synon zotërimin përfundimtar të natyrës dhe shoqërisë njerëzore, permes njohjes dhe pranimit të "Tao-s". Kjo lloj "Tao-je" nuk nënkupton konceptet apo standartet e vërësimit të lirisë, arsyes, demokracisë dhe drejtësisë, por nënkpton diçka speciale që nuk mund të emërtohet, një ligj të përjetshëm.

Mendimi filozofik i Laozi, si burim i Taoizmit, ka pasur një ndikim të jashtëzakonshëm jo vetëm ndaj kulturës tradicionale kineze, por edhe ndaj formimit psiko-kulturor të vetë kinezëve. Ndikimi i tij shtrihet jo vetëm në shkencat filozofike, politike, sociale, e aspekte të tjera, por edhe në fushën e edukimit, politkës, ekonomisë, psikologjisë, ligjëshmërisë, etj. Po kështu mendimi i tij filozofik ka ndikuar jo vetëm në formimin e mentalitetit te kinezëve, por gjithashtu ka pasur ndikim të konsiderueshëm edhe ndaj Japonisë dhe Perëndimit.

Duke filluar nga shekulli i 19-të e deri më sot, në Perëndim janë botuar disa variante përkthimi të "Tao Te Ching". I pari që e ka përkthyer këtë vepër në anglisht ka qenë misionari protestat nga Skocia, John Chalmers në vitin 1868. Në gjuhët e perëndimit është përkthyer rreth 250 herë, kryesisht në anlgisht, frëngjisht dhe gjermanisht, nga sinologë, studiues e përtkthyesit më të shquar. Mendohet se "Tao Te Ching" është libri me karakter kulturor më i përkthyer dhe botuar në gjuhë të huaja pas Biblës.

"Tao Te Ching" vjen për herë të parë në gjuhen shqipe me përkthim të drejtpërdrejtë nga origjinali. Në fakt përkthimi nga gjuha kineze ka qenë një vendim i vështirë i përtkhyesit dhe botuesit, kjo edhe për shkak të vështirësive që ai paraqet si në aspektin gjuhësor, ashtu edhe në aspektin e interpretimit. Është synuar ti qëndrohet besnik në maksimum tekstit në variantin origjinal në kinezisht, por sigurisht duke u ballafaquar dhe orientuar nga interpretmet e studiuesve kineze të këtij teksti. Ndërsa për titullin e librit gjithashtu është menduar të përdoret varianti i përkthimit anglisht, "Tao Te Ching", kjo për faktin se përkon më shumë edhe me shqiptimin në gjuhën shqipe të titullit të origjinalit te transkiptuar , si dhe me termin *Taoizëm*, tashmë të njohur dhe të pranuar në gjuhën shqipe. Titulli i këtij libri në origjinal është "道德经" – e transkiptuar me *pingyin* lexohet Dao De Jing ose Daodejing, ku Dao (道) – ka kuptim e rrugës, arsyes, etj, kurse De (德) ka kuptimin e virtytit, karakterit personal ose integritetit personal. Ndërsa sëbashku këto dy karaktere Daode (道德) kanë kuptimin e moralit, etikës morale, principeve morale. Ndërsa Jing (经) ka kuptimin e Kodit, Veprës klasike, etj. Kjo është arsyeja që titulli i veprës është përkthyer në disa variante në gjuhë të huaja, ku mund të përmendim " Rruga drejt Virtytit", "Kodi Moral", "Libri i Tao-s dhe Virtyti i Tij", "Kodi arsyes dhe Virtytit", "Libri klasik i integritetit dhe rruga drejt tij", e një sërë titujsh të tjerë. Megjithatë aktualisht titulli më i pranuar është ai i përzgjedhur nga ana jonë, "Tao Te Ching" ose "Daodejing".

Mendimi filozofik i Laozi, si burim i Taoizmit, ka pasur një ndikim të jashtëzakonshëm jo vetëm ndaj kulturës tradicionale kineze, por edhe ndaj formimit psiko-kulturor të vetë kinezëve. Ndikimi i tij shtrihet jo vetëm në shkencat filozofike, politike, sociale, e aspekte të tjera, por edhe në fushën e edukimit, politkës, ekonomisë, psikologjisë, ligjëshmërisë, etj. Po kështu mendimi i tij filozofik ka ndikuar jo vetëm në formimin e mentalitetit te kinezëve, por gjithashtu ka pasur ndikim të konsiderueshëm edhe ndaj Japonisë dhe Perëndimit, duke u shdërruar një mendim të rëndësishëm me përmasa ndërkombëtare. Në kohën e sotme të konsumizmit dhe dixhitalizimit global, mendimi filozofik i Laozi është një sinjal i rëndësishëm për ruajtjen e ekuilibreve të domosdoshëm natyrorë si dhe iu tregon njerëzve sit ë shohin dhe trajtojnë me mençuri rrugën e jetës, rrugën sociale dhe rrugën e universit. Ashtu siç ka mbijetuar për mbi 2500 vjet, mendimi i tij filozofik nuk do të shuhet me kalimin e gjeneratave, por do të vazhdojë të ndikojë njerëzimin edhe në shekujt pasardhës.

Përgatiti : Iljaz Spahiu (Sinolog)

NARRATIVA NË ROMANIN "BRETKOSAT" TË MO YAN

nga Eranda Allmetaj (PhD)

"Bretkosat" e Mo Yan vjen në gjuhën shqipe e përkthyer me mjeshtëri dhe profesionalizëm nga sinologu Iljaz Spahiu. Kryevepra e shkrimtarit kinez Mo Yan, fituese e çmimit Nobel në letërsi, tashmë është prezente për lexuesin shqiptar duke shpalosur botën e gjerë kulturore të shoqërisë kineze të disa viteve më parë.

Vepra strukturohet në pesë pjesë, të cilat në vetvete përfaqësojnë dhe shpalosin historinë e një subjekti të caktuar; histori vetjake e një personazhi, e cila ndërthuret dhe përplotëson tablonë e plotë të të gjithë veprës. Secila pjesë është e ndarë në pjesë të tjera, ku në secilën prej tyre rrëfehet ngjarja, që si bosht kryesor ka një personazh të caktuar dhe tregohet lidhja e tyre me personazhin kryesor, hallën.

Halla, e njohur me emrin Gu Gu, është personazhi rreth të cilit ndërthuren ngjarjet e kësaj vepre. Me profesion mjeke, ajo është dëshmitarja kryesore e shumë familjeve kineze të cilat përjetuan periudhën e planifikimit familjar. E ngjashme me një vepër monografike, kushtuar personazhit të hallës, "Bretkosat" shpalos jo vetëm përjetimet e saj, por edhe të një shumësie personazhesh të tjerë, rrëfimi i jetës së të cilëve është dëshmia kryesore e përjetimeve të dukurisë së planifikimit familjar, ku *"një fëmijë nuk është pak, dy janë tamam, tre janë shumë"*. (79, Bretkosat)

Personazhi i hallës, krahas punës si mjeke, ishte i përfshirë edhe në detyra të tjera shtetërore, si: anëtare e përhershme e Këshillit Konsultativ dhe zëvendëspërgjegjëse e grupit drejtues të planifikimit familjar; detyra të cilat e kishin bërë profesionin fisnik të mjekësisë shpeshherë të komplikuar dhe të përzier me reformat shtetërore, të cilat në shumë raste i kishin sjellë dëme në reputacionin e saj në shoqëri, ku kjo e fundit i kishte vënë emërtimin "Djalli i mishëruar".

Një kontradiktë e madhe morale dhe profesionale bashkëshoqëron këtë personazh që herë personifikohet si engjëll, kur sjell në jetë fëmijën e parë të një familje, dhe herë si djall, kur ndërpret mundësinë e ardhjes në jetë të atyre që përcaktoheshin si "fëmijë të paplanifikuar". Bota e hallës, por edhe e shumë personazheve të tjerë, kryesisht femërorë, është e mbushur me mundime dhe peripeci, të cilat i detyrojnë të marrin vendime qe nuk përputhen me dëshirat e tyre.

Në pjesën e parë të veprës kemi ndërfutjen e një prologu në formën e një letre të shkruar nga rrëfimtari Ke Gou për mikun e tij japonez, Joshito Sugitani. Shkëmbimi i ndjesive dhe kujtimeve të narratorit rreth jetës së tij dhe personazheve të tjerë përreth përbëjnë endjen e subjektit narrativ të kësaj vepre. Vepra hapet me një letër miqësore, për t'u përmbyllur me një dramë me 9 akte; dramë si një lloj letrar, por njëkohësisht dramë në kuptimin simblik të asaj çka përfaqësonte jeta e secilit personazh të saj.

Rrëfimi kryesisht realizohet nëpërmjet një narratori të jashtëm, siç është Ke Dou, por shpeshherë ndeshemi edhe me rrëfimin e drejtpërdrejtë të vetë personazheve, të cilët në mënyrë subjektive përshkruajnë dhe japin detaje rreth historive të ndryshme. Në aspektin narrativ, e tashmja dhe e shkuara ndërthuren me njëra- tjetrën nëpërmjet procesit të retrospektivës dhe teknikës së përshkrimit, funksioni i të cilave është plotësimi sa më i plotë i asaj çka përfshin përjetimin dhe ndikimin e së shkuarës.

Ndër aspektet thelbësore të veprës së Mo Yan janë personazhet e saj, të cilët përbëjnë thelbin apo boshtin kryesor të subjektit të trajtuar. Me një rrëfim të detajuar të përjetimeve të tyre shpirtërore dhe psikologjike, shkrimtari sjell pranë lexuesit një botë të tërë emocionesh e ndjesish, që prekin drejtpërdrejtë jetën e tyre në aspektin familjar dhe shoqëror. Shpalosja e ngjarjeve nëpërmjet ligjëratës së drejtë të personazheve dhe ligjëratës së zhdrejtë të narratorit sjell në sytë e lexuesit vërtetësinë e detajeve prekëse dhe gjykimin e personazheve rreth tyre.

Personazhet, sipas traditës kineze, marrin emra bazuar në shkollimin e tyre apo tipare të tjera, të cilat kanë të bëjnë me karakteristika të jashtme të fizikut. Ndër to mund të përmendim: Chen Hunda, Chen Vetulla, Yuan Fytyra, Li Dora, Xiao Buzepërmi, Wan Zemra, He Dorëmadhi etj. Emrat e tyre janë përshtatur sipas gjuhës shqipe, por herë-herë vijnë të shkruara edhe sipas shqiptimit kinez.

Në vepër gjejmë të përfshira bestytni, tradita, zakone dhe ngjarje historike të shoqërisë kineze, të tilla si përdorimi i simbolikës së kukullës për të përfaqësuar praninë e një fëmije. Sipas narratorit: *"Në fshat thuhej se kush blinte kukullat e dala nga dora e He Dashout, nëse u lidhte një fjongo të kuqe në qafë dhe i vendoste te koka e shtratit, fëmijët që do të lindnin do të ishin njësoj si kukullat…nëse kukulla që ai do të shiste ishte vajzë, ti me siguri do të lindje vajzë, nëse të shiste djalë, do të ishte djalë. Nëse kapte dy kukulla, do të lindje binjakë"*. (129, Bretkosat)

Dukuria e planifikimit familjar vjen e përshkruar sipas gjykimeve të ndryshme që kanë personazhet rreth saj, por duke qenë të përfshirë në këtë dukuri, ato herë pas herë kanë përplasje me personazhin e hallës, e cila për shkak të detyrës si drejtuese, organizatore dhe zbatuese e punës për "lindjen me plan" të komunës, është në fron të parë të kritikave dhe kundërshtimeve të shoqërisë.

Në këndvështrimin e hallës planifikimi ishte direktivë e kryetarit dhe kjo nuk duhej të vihej në diskutim, ndërsa sipas narratorit kryesor, Ke Dou, në një letër drejtuar mikut të tij japonez ai shprehet se *"dukuria e planifikimit nuk ishte në të mirë vetëm të zhvillimit të Kinës, por ishte gjithashtu edhe një ndihmesë për gjithë njerëzimin"*.

Ndërkohë që, sipas nënës së saj, *"lindja e fëmijëve, që nga kohët e lashta, është puna më e zakonshme, punë e tokës dhe e qiellit"*. Sipas saj, kjo është dukuria më e natyrshme në të gjithë historinë njerëzore.

Romani përman rrëfimin rreth cikleve të plota jetësore duke përfshirë foshnjërinë deri tek pleqëria; kjo për të treguar që periudha rreth së cilës rrëfehet mund të ketë qenë një periudhë e caktuar historike kontekstuale, ndërkohë që për vetë njerëzit cdo periudhë historike e vendit ku ato jetojnë është vetë jeta dhe ekzistenca e tyre. E tillë qëndron edhe për personazhet e këtij romani.

Ato mund të zotërojnë fuqinë vendimmarrëse për shkak të pushtetit, por nuk i shpëtojnë dot forcës së ndërgjegjes, e cila sa vjen e thellohet. Pasojat e veprimeve, që në rastin më të keq kanë ndërgjegjen si gjyqtare të shpagimit moral, prekin jo vetëm individin si qenie, por gjithashtu edhe shëndentin mendor e shpirtëror.

Raporti me kohën krijon përfytyrime në sytë e lexuesit duke e sjellë atë më pranë realitetit kinez, jo vetëm në mënyrë sipërfaqësore, por duke përfshirë edhe anën ndjesore të karaktereve, të cilët në vetvete përbëjnë thelbin e këtij realiteti. Ridimensionimi i personazheve në mënyrë të vazhdueshme gjatë narracionit, ndërthurur me rrethanat në të cilat ato vendosen e shpërfaqin atë në mënyrë të shumëanshme. Ndërveprimi i narratorit me lexuesit përplotësohet më së miri nëpërmjet aftësisë përçuese të subjektit në mënyrë besnike, pa anashkaluar detajet të cilat formojnë mozaikun jetësor të një periudhe të caktuar kohore dhe kontekstuale.

Aftësia e Mo Yan për ta bërë simbolikën e subjektit të duket si rrrëfim i drejtpërdrejtë, por shpeshherë me një thjeshtësi që në mënyrë paradoksale duket njëkohësisht edhe e ndërlikuar, e bën atë ndër shkrimtarët më të spikatur në botën letrare kineze.

Kontradikta të tilla ndërthurin të gjithë subjektin e veprës dhe shërbejnë si rrëfim i asaj çka është konsideruar si realiteti në shoqërinë kineze të atyre viteve. Pikërisht për shkak të këtij realiteti, vërtetësisë e mjeshtërisë së përshkrimit në një mënyrë të rrallë, vepra "Bretkosat" është vlerësuar më çmime të ndryshme në Kinë dhe jashtë kufijve të saj, duke marrë vëmendjen e kritikës letrare dhe të studiuesve të ndryshëm.





TATJANA TOLSTAJA

NË KUJTIM TË BRODSKIT

Përktheu nga origjinali: Nikolla Sudar

Kur nxirren nga shtëpia plaçkat e fundit, në ndërtesë ushton një jehonë e fortë, gjëmuese: zëri yt reflektohet nga muret dhe kthehet përsëri tek ti. Tingëllimi i vetmisë, rryma e boshllëkut, humbja e orientimit dhe ndiesia e lirisë, që të kall krupën: të gjitha janë të mundshme dhe gjithçka është idiferente, asnjë dhe askush nuk të kthen përgjigje, përveç trokitjes së dobët dhe ritmike të hapave të tuaja. A nuk e ndien kështu veten tashmë letërsia ruse: vetëm katër vjet nga përfundimi i shekullit, ajo humbi poetin e saj më të madh të gjysmës së dytë të shekullit njëzet dhe për një të ri në këtë mijëvjeçar, as që mund të shpresohet. Josif Brodski u largua përgjithnjë dhe shtëpia jonë është bosh. Me Rusinë, vetë ai u nda dy dhjetëvjeçarë më parë, u përpoq të bëhej amerikan, e deshi Amerikën, shkroi ese në anglisht, por Rusia - është vend që të shtrëngon fort: sado që të përpiqesh të shkëputesh, ajo të mban të mbërthyer gjer në fund.

Kur dikush vdes, në Rusi është bërë zakon të mbulohen pasqyrat me një vello të zezë - një zakon i lashtë, kuptimi i së cilës është harruar apo deformuar. Në fëmijëri kam dëgjuar se kjo bëhet që i ndieri, i cili edhe për nëntë ditë do të bredhë nëpër shtëpi, duke u ndarë nga të afërmit, të mos trembet, duke mos gjetur në pasqyrë pamjen e vet të mëparshme e të zakonshme. Gjatë jetës së tij të shkurtër, të pamerituar, por jashtë mase të pasur, Josifi është pasqyruar në kaq shumë njerëz, fate, libra, qytete, saqë në këto ditë të përzishme, kur ai në mënyrë të padukshme lëviz mes nesh, dëshiroj të hedh vellon e zisë mbi të gjitha pasqyrat e tij të dashura: mbi lumenjtë e mëdhenj, që lagin Manhatanin, mbi Bosfor, mbi kanalet e Amsterdamit ("holandezët janë populli më i mirë në botë"), mbi ujërat e Venecias, të cilave ai u thuri këngë, mbi rrjetin arterial të Petërburgut (njëqind ishuj - po sa lumenj?) - qytetin e tij të lindjes, të dashur e të egër, prototip i të gjitha qyteteve të së ardhmes. Atje - kur ende ishte një djalë i vogël - e dënuan sepse ishte poet, që do të thoshte, dembel - me sa duket, ai ishte i vetmi në Rusi, ndaj të cilit u zbatua ligji i egër dhe i saposhpikur, që të ndëshkonte për mungesën e dëshirës për të fituar nga puna. Natyrisht që nuk qëndron këtu problemi, sepse me nuhatjen prej bishe e ndienin, tashmë, shumë mirë se KUSH ndodhej para tyre. Ata i fshinë dokumentet e paraqitura për disa kopekë, që përfitonte Josifi nga përkthimi i poezive. "Kush ju ka cilësuar poet? - ulërinin kundër tij. "Unë mendoj... unë mendoj se këtë e ka bërë Zoti". Pasojat janë të kuptueshme: burgu, internimi. "As vendin dhe as varrezat nuk dua t'i veçoj, // Në ishullin Vasiljevsk dua të mbaroj", premtonte ai në vargjet e kohës së rinisë. "Pamjen tënde të murrëtyer, në errësirë nuk e dalloj // Midis linjave dalëboje, në asfalt do të përfundoj... Prandaj edhe nuk donte të kthehej në Rusi, më duket mua, qoftë edhe për një ditë, për të mos u realizuar kjo profeci e lëshuar pa kujdes: ndër të tjerë - nxënës i Ahmatovës dhe i Cvetajevës, ai ua njihte bestytnitë poetike, kishte dijeni rreth bisedës së tyre, e cila u zhvillua gjatë kohës, ndoshta, të të vetmit takim, që ndodhi me gratë e mëdha. "Si mundët të shkruani (të tilla vargje): vallë, nuk e dinit se fjalët e poetit gjithmonë realizohen?!" - e qortoi njëra prej tyre. "Po si mundët t'i shkruanit (këto vargje)?! - u habit tjetra - sepse profecia e tyre doli me të vërtetë.

"Josif, a do të shkoni në Rusi?" - "Sigurisht". "Nuk e di. "Ndoshta". "Jo këtë vit". "Duhet të shkoja". "Nuk do të shkoj". Të tërë u sulën drejt Rusisë - dikush për ta parë, ndërsa dikush edhe përgjithmonë - Brodski u lëkund, por mbeti pa shkuar. Unë u njoha me të në vititn 1988, gjatë vizitës sime të shkurtër në Amerikë, kurse në Moskë më thirrën papritur në mbrëmjen kushtuar Brodskit. Një mik i vjetër lexoi vargjet e Josifit, pastaj u luajtën pjesë muzikore, që s'kishin asgjë të përbashkët me të, por që i kushtoheshin atij. Të arrije gjer te salla e koncerteve ishte e pamundur; në rrugët, që ndodheshin afër, kalimtarët të zinin përdore, duke të lutur t'u shisje "një biletë të tepërt". Salla ruhej nga policë mbi kuaj dhe mund të mendoje se pritej ndonjë koncert rroku. Për tmerrin tim të madh, unë e kuptova se mbështeteshin tek unë: isha i pari njeri i gjallë që e kishte parë poetin pas shumë vjetësh mërgimi. Ç'mund të thoja unë? Ç'mund të flisje për një njeri, me të cilin ke kaluar vetëm dy orë? Unë kundërshtova, por mua më shtynë fort drejt skenës, ku e ndjeva veten një idiote. Po, e kisha parë Brodskin... Po, të gjallë. Të sëmurë. Pinte duhan. Së bashku pimë kafe. Sheqer nuk kishte në shtëpi (Zemërim në sallë: a mos po e ofendojnë poetin tonë amerikanët? Si është e mundur të mos kishte sheqer?) Po tjetër? Por ja ku erdhi Barishnjikovi, që solli dru dhe ne e ndezëm oxhakun (Shqetësim në sallë: a mos ka rrezik të ngrijë atje poeti ynë?). Po në cilin kat banon? Me çfarë ushqehet ai? Çfarë po shkruan? Si shkruan, me dorë apo me makinë shkrimi? Çfarë librash ka botuar? A e di ai se ne e duam? Po a do të vijë? A do të vijë? A do të vijë?

"Josif, a do të shkoni në Rusi?" - "Atje nuk i duhem kujt". "Mos u tregoni kapriçioz! Atje nuk do t'ju lënë të ecni. Juve do t'ju mbajnë ndër duar - bashkë me gjithë avionin. Turma do të derdhet e tëra, do të përmbysë doganën e aeroportit Sheremetjevo dhe do t'ju përcjellin drejt Moskës ndër duar, me këngë. Ose gjer në Petërburg. Po deshët - edhe mbi kalë të bardhë". - "Ja përse nuk dua. Por edhe sepse atje nuk kam nevojë për asnjërin". - "S'është e vërtetë! "Po intelektualet e moshuara e të thjeshta, lexueset tuaja, - bibliotekaret, punonjëset e muzeve, pensionistet, banoret e ndërtesave komunale, të cilat druhen të duken në kuzhinën e përbashkët me çajnikun e ciflosur? Po ata, që në filarmoni ulen prapa, afër kolonave, ku kushton më lirë? A nuk keni dëshirë t'ju shohin nga larg lexuesit tuaj të vërtetë? Përse i ndëshkoni ata? Ajo qe një pritje e turpshme! Pa takt dhe e pandershme! Ose ai ka bërë shaka: "Ja, më mirë është të shkoj tek holandezët e mi të dashur", "Italianët i adhuroj, do të shkoj tek ata", "Polakët janë të çuditshëm! Ata po më thërrasin" ose zemërohej dhe godiste pjesën e sipërme të dorës: "Ata nuk më lejuan të varrosja babanë! Nëna më vdiq pa më parë - iu luta - ata më refuzuan!". - "Kush ju refuzoi - lexuesit tuaj?".

A dëshironte ai të vizitonte shtëpinë? Sipas meje, në fillim, sidoqoftë, ka pasur shumë dëshirë, por nuk pati mundësi; ai u trembej të kaluarës, kujtimeve, ndodhive, varreve të hapur; i trembej dobësisë së vet se mos shkatërronte atë që kishte bërë në të kaluarën me vargjet e veta; ai trembej të kthente kokën prapa për të parë të kaluarën - si Orfeu - Euridikën. Ai nuk mund të mos e kuptonte se i vetmi lexues i tij, lexues i vërtetë i tij është atje; ai nuk mund të mos e dinte se

është poet rus, ndonëse e kishte bindur veten - vetëm vetveten - se ishte poet amerikan. Ai shkruante vargje në gjuhën angleze, vjershat e veta i përkthente në anglisht, zemërohej nganjëherë për shkak të reçensioneve thumbuese, për shkak të miqve shumë të afërt, që guxonin t'i thonin atij: "... po, Josif, fjalët janë me vend, por vjersha nuk është e goditur, sepse, siç e di, poezia angleze ka ligje të tjera...". Ai nuk kishte përse të njihte gjithçka kishte të bënte me ligjet e poezisë në botë - sepse ai i krijon vetë ato! "Mos i fol Josifit, por duhet ta dish se përsëri kanë ardhur amerikanë dhe kanë pyetur: "Na thoni, a është e saktë se me të vërtetë është një poet gjenial?". Çfarë dinte ai dhe çfarë hamendësonte? Ai ka shkruar një vjershë për skifterin e maleve të Masaçusetsit, i cili fluturon aq lart, saqë rryma e lëvizshme e ajrit nuk e lejon të zbresë poshtë në tokë dhe skifteri vdes atje, në atë lartësi, ku nuk ka as zogj, as njerëz, as ajër, për të thithur. A mund të kthehej më ai prapa? Përse unë dhe të tjerë e torturonim me pyetjet rreth kthimit? Ne dëshironim që të ndjehej rehat, që të shihte e të mësonte se sa e duan atë - vetë ne e donim shumë atë! Dhe unë deri më sot nuk e di, a i pranonte ujditë "për të vizituar atdheun" apo ato ia sfilitnin zemrën e sëmurë. "Josif, ju kanë ftuar të flisni në një kolegj. Ja të dyja datat: në shkurt apo në shtator?" - "Siguristh, që në shkurt. Sa për në shtator, të jemi gjallë gjer atëherë!". Dhe, duke i hequr filtrin cigares së radhës, ai tregoi një anekdotë "të hidhur" të radhës: BURRI: "Mjeku më tha se ky është fundi. Unë nuk e shtyj gjer në mëngjes. Hajt ta kalojmë natën e fundit duke bërë dashuri dhe duke pirë shampanjë!". GRUAJA: Pa shih, sa i mençur! Ti nuk do të ngrihesh më në mëngjes!". A duhej të trajtohej ai si një i "sëmurë" - të flitej për kohën dhe të ecej në majë të gishtërinjve"? Erdhi te ne në kolegj, dyll i zbehtë, i torturuar nga tri orë udhëtim - në raste të tilla thirej 911. Piu verë, tymosi një gjysmë pakete cigaresh, i erdhi çehrja dhe filloi të lexojë vargje, vargje, vargje, - tymoste dhe deklamonte përmendsh, vargje të vetat dhe të huajat; përsëri filloi të tymosë dhe të lexojë, ndërsa dëgjuesit, tashmë, u zbardhën nga tymi i tij antiamerikan, ndërsa ai ishte entuziazmuar i tëri - fytyra i ishte skuqur, sytë i shkëlqenin dhe vazhdonte e vazhdonte të lexonte. Dhe, kur sipas të gjitha rregullave, duhet të kishte rënë në shtrat me tabletin e nitroglicerinës nën gjuhë - shfaqi dëshirën akoma të fliste dhe shkoi te mikpritësit, që e kishin ftuar, Bob dhe Pegi Bojers, pronarë të shtëpisë botuese "Sallmagundi". Gjer në mesnatë ai vazhdoi të flasë, të pijë, të tymosë, të shkëlqejë me talentin e vet, të qeshë, kur tashmë të zotët e shtëpisë të duruar e të mësuar në raste të tilla ishin zverdhur në fytyrë dhe unë bashkë me burrin e shoqëruam në shtëpinë e miqve, energjitë e tij u shtuan në ato përmasa, që neve na u pakësuan. "Sa të mrekullueshëm janë Bojersët! Sa i mençur është ai! Sa e bukur është ajo! Sa dëshirë kam të mos largohem nga miq të tillë - por ja që i vumë pakëz në mundime! Ndërsa tashti do të sillemi ashtu siç duhet!". Siç duhet - do të thotë sipas mënyrës ruse. Dhe ne ndenjëm gjer në tre të mëngjesit në dhomën e zbrazët të pritjes, duke biseduar për gjithçka në botë, sepse Josifin e interesonte çdo gjë, duke gërmuar nëpër sirtare për të gjetur hapëse për shishet e tjera të verës së kuqe, duke e mbushur mjedisin e këndshëm amerikan me shtëllungat e tymit të ndaluar dhe duke kërkuar me kujdes ushqime të mbetura nga pritja e ditës ("duhet të kishim fshehur *lo-mein*... Pastaj akoma kishte mbetur një pulë e shijshme... Edhe të ftohtë do ta kishim ngrënë - ajo duhej vjedhur! Natën oreksi është i madh!") dhe afër mëngjesit u shpërndamë - ne gjysmë të gjallë, ndërsa Josifi - sikur s'kishte ndodhur asgjë.

Me një përzemërsi të jashtëzakonshme sillej ai ndaj të gjithë miqve të vet petërburgas, duke lëvduar pa kursim virtytet e tyre, të cilat nuk i zotëronin gjithnjë. Kur vinte çështja te besnikëria njerëzore, nuk mund t'i besoje vlerësimeve të tij - Të gjithë për të ishin gjeni, mozartë, poetët më të mirë të shekullit XX - plotësisht në traditën ruse, dhemshuria e tij e kapërcente realen, ndërsa dashuria qëndronte mbi të vërtetën. Shkrimtarë dhe poetë të rinj nga Rusia e mbytën atë me dorëshkrimet e tyre, ndërsa kur u nisa nga Moska për në Amerikë, miqtë e mi poetë sollën vëllimet e tyre dhe m'i futën më forcë në valixhe: "Nuk rëndojnë shumë. Kryesorja është, t'ia tregosh Brodskit. Thjesht për t'i lexuar. Nuk kërkojmë më shumë - thjesht për t'i lexuar!". Dhe ai i lexonte, i mbante mend, u shkruante se poezitë ishin të mira, jepte intervista, duke lavdëruar fatlumturin, ndërsa ata i dërgonin pa pushim publikimet e veta. Të lavdëruarve u merreshin mendtë, kurse disa shpreheshin: "Në fakt, në Rusi ka dy poetë të vërtetë: Brodski dhe unë". Ai krijoi për veten e vet përshtypjen e rreme të patriarkut-zemërmirë - por do të kishte qenë mirë që shkrimtari i ri, emrin e të cilit nuk po e përmend, ta kishte parë se si, duke lexuar me përkushtim, që nuk e kuptoj përse, tregimin e tij me një subjekt, të ndërtuar për kënaqësitë e një morali të ndyrë, i prekur thellë, Brodski pështynte dhe bërtiste: "Po mirë, mirë, pas KËSAJ mund të vazhdosh të shkruash. Por si mund të jetojë ai pas KËSAJ që ka shkruar?!".

Josifi nuk shkonte asgjëkundi - të tërë vinin tek ai. Të tërë, të ardhurit ia dërgonin atij. Të tërë krijuan bindjen se ai me të vërtetë ekziston, jeton dhe shkruan - një poet i kaq çuditshëm rus, që nuk dëshiron më ta shkelë tokën ruse. Veprat e tij në Rusi botoheshin nëpër gazeta, revista, në botime me një vëllim dhe me shumë vëllime; atë e citonin, atij i referoheshin, e studionin, ia botonin veprat herë siç dëshironte, e herë jo, ia shtrembëronin ato dhe e shfrytëzonin; atë e shndërruan në një mit. Një testim në rrugët e Moskës: "Çfarë shpresash keni për të ardhmen lidhur me zgjedhjet e reja parlamentare?". Mekaniku N: "Ohu, më vjen të pështyj, edhe mbi parlamentin, edhe mbi politikën. Unë dua të bëj një jetë të ndershme, ashtu si Brodski".

Ai kishte dëshirë të jetonte dhe të mos vdiste - as në ishullin Vasiljevsk dhe as në ishullin Manhatan. Ai ishte i lumtur, kishte një familje të dashur, kishte vargjet, miqtë, lexuesit, nxënësit. Ai donte të largohej me vrap nga mjekët drejt kolegjit të vet - atëherë ata nuk do ta arrinin dot. Ai donte t'i shpëtonte profecisë se vet: "Midis linjave të dalëboje, në asfalt do të përfundoj". Ai u rrëzua mbi dyshemenë e kabinetit të vet, afër ishullit tjetër, pranë linjave të kryqëzuara, të fatit të dyfishtë prej emigranti - të atij rus dhe amerikan: "Dhe dy vajzat-motra, në moshë akoma të mitur // Përshëndesin djalin, drejt ishullit duke ikur". Dhe, në realitet, ai i la vetëm dy vajzat - gruan dhe të bijën.

A e di si është puna, o Josif, nëse ju nuk doni të udhëtoni me zhurmë dhe pompozitet, nuk doni as kalë të bardhë dhe as turma të entuziazmuara - përse të mos shkoni në Petërburg inkonjito?" - "Inkonjito?" - ai nuk zemërohet menjëherë dhe nuk bën shaka, por dëgjon më vëmendje. "Po, a e dini se si - ngjisni një palë mustaqe ose thjesht... mbulohuni me gazetë në aeroplan. Askujt, mos i tregoni - në përgjithësi, askujt. Do të arrini atje, do të uleni në një trolejbus dhe do të udhëtoni nëpër prospektin Njevksi; do të ecni rrugëve, i lirë dhe pa rënë në sy. Futuni në turmë, ku të tërë shtyhen. Blini një akullore. E kush do t'ju njohë? Po patët dëshirë - telefonojuni miqve nga rruga, - mund t'u thoni se po flisni nga Amerika. Dhe nëse ju pëlqen - trokisni në derën e mikut: Ja, ku jam. Thjesht u ktheva - se u mërzita". Unë i flas, bëj shaka dhe papritur vë re se nuk e merr aspak për shaka - në fytyrën e tij shfaqet një dobësi prej fëmije, shfaqet pamja e një ëndërruesi të çuditshëm; vështrimi sikur i depërton përmes sendeve, përmes kufirit të gjërave - në anën tjetër të kohës... Ai hesht dhe unë e ndiej veten ngushtë, tamam sikur po vështroj, sikur po futem atje ku nuk më takon dhe, për ta shmangur këtë gjë, i flas më zë të butë dhe kurajoz: "A nuk është me të vërtetë një ide e mrekullueshme?...".

Me vështrimin e vet depërtues, ai më thotë: "E mrekullueshme... E mrekullueshme...".

Autori dhe presidenti i dyzetedytë i Shteteve të Bashkuara të Amerikës rrëfen se si ka gjetur mirakanden te thrillerat – dhe frymëzimin te William Styron, James Baldwin dhe Maya Angelou

BILL CLINTON:

"KAM DASHUR GJITHMONË TË BËHEM SHKRIMTAR, POR DYSHOJA NË AFTËSINË TIME



Libri që po lexoj ndërkohë

The end of Everything nga Katie Mack. Fizikania teorike shpjegon pesë fundet më të mundshme të universit tonë që po zgjerohet, me shpresën se do të vijnë pas një kohe jashtëzakonisht të largët. Është me humor, i qartë dhe optimist. Shkon me librin *Until dhe End of Time* të Brian Greene. Gjithashtu po lexoj *Minds Wide Shut* nga Gary Saul Morson dhe Morton O Schapiro, një studim përfshirës mbi shtimin e bindjeve të ngurta në politikë, ekonomi dhe letërsi, si dhe kërcënimeve që i paraqesin demokracisë, e cila kërkon mendje të hapur dhe kompromis.

Libri që më ndryshoi jetën

The Denial of Death nga Ernest Becker. Më bëri të rimendoj rrënjët e frikërave dhe pasigurive tona më të thella, dhe pse shpesh e zhgënjejmë veten me mënyrën se si i manifestojmë.

Libri që do të doja të kisha shkruar

Njëqind vjet vetmi nga Gabriel García Márquez. Unë ende mendoj se është romani më i mirë i shkruar që pas vdekjes së William Faulkner-it.

Libri që pati ndikimin më të madh në shkrimet e mia

Gjithmonë kam dashur të jem shkrimtar, por kam dyshuar në aftësinë time për ta bërë. Që nga viti i fundit i kolegjit e deri te viti i parë në degën e drejtësisë, lexova pesë libra që më bënë të mendoj se ia vlente ta provoja: *North Toward Home* nga Willie Morris; *The Confessions of Nat Turner* nga William Styron; *You Can't Go Home Again* nga Thomas Wolfe; *The Fire Next Time* nga James Baldwin; dhe *I Know Why the Caged Bird Sings* nga Maya Angelou.

Libri që më ka ndryshuar mendjen

Kjo është pyetje bukur. Mendoj se *Caste* i Isabel Wilkerson dhe *Think Again* i Adam Grant më bënë të rimendoj se sa thellësisht të ngulitura janë paragjykimet tona të pavetëdijshme, jo vetëm në lidhje me racën, gjininë, klasat dhe fenë, por me çdo numër kategorish që na nxisin t'i shohim të tjerët si inferiorë, si më pak të denjë për t'u parë e dëgjuar. Më pëlqen metoda e pajtimit dhe e bashkimit ripërtëritës të Nelson Mandela-s.

Libri i fundit që më ka bërë të qaj

Sooley nga John Grisham. Lexoje, dhe do të duash të qash edhe ti.

Libri i fundit që më ka bërë të qesh

Libri i fundit e Janet Evanovich-it. Stephanie Plum më bën gjithmonë të qesh.

Libri që më vjen turp që s'e kam lexuar ende

Uliksi. Më pëlqen poezia, proza dhe *nonfiction*-i irlandez. E adhuroj Joyce-in. Por gjithmonë lodhem e heq dorë përpara se ta filloj. Do vazhdoj të përpiqem.

Librat që kam dhuruar

Meditimet nga Marcus Aurelius; *The Cure at Troy* nga Seamus Heaney; dhe *The Social Conquest of Earth* nga EO Wilson. Secili është i mbushur me mençuri sipas mënyrës së vet.

Libri me të cilin dua të mbahem mend

Deri tani *Jeta ime*, për arsyet që Larry McMurty deklaroi në shqyrtimin e tij: është një histori e jetës dhe kohës sime; një rrëfim se si është të jesh president kur kaq shumë gjëra ndodhin njëkohësisht, me shpjegime të mëtejshme të ndodhive si Black Hawk Down që nuk do t'i gjeni askund tjetër; një testament i asaj që unë besoj dhe pse.

Leximet që më japin rehati

Gjej rehati në thrillerat me personazhe interesante dhe subjekte të mira. Më ka pëlqyer shumë *While Justice Sleeps* e Stacey Abram, dhe gjithë librat e Louise Penny-t, librat e VI Warshwaski të Sara Pertsky, librat e Easy Rawlin të Walter Mosley, seritë me Dave Robicheaux të James Lee Burke, dhe librat Bosch të Michael Connelly-t. Më pëlqen *Gabriel Allon* i Daniel Silva, David Baldacci dhe Lee Child janë duke u bërë më të mirë akoma. Dhe i adhuroj librat e bashkautorit tim James Patterson, sidomos ato me Michael Bennet dhe Alex Cross. Uroj që libri ynë i ri, *The President's Daughter*, të përfshihet edhe në listën e të tjerëve. Më pëlqejnë personazhet dhe subjekti.

Libri që mendoj se është më i nënvlerësuar

Ndoshta libri *Grant* i Ron Chernow-t. Ai ngre një çështje të pakundërshtueshme jo vetëm për gjeninë e Grant-it si udhëheqës ushtarak, por edhe për kurajën dhe vendosmërinë e tij për të garantuar që lufta civile amerikane të mos ishte e kotë. Me përpjekjet e fundit për të diskredituar zgjedhjet e vitit 2020, miratimin e masave për shtypjen e votuesve, dhënien fund të komisionit për hetimin e trazirave në Capitol në 6 janar, dhe ndryshimin e përbërjes së gjykatës së lartë, ne na kujtohet ajo çfarë dinte Grant-i: rreziqet që vijnë nga përsosja e bashkimit tonë përfshijnë mundësinë se reagimi i pashmangshëm mund të na e heqë demokracinë.

RRËMIHËSI

Tregim nga Samanta Schweblin

Përktheu nga spanjishtja Erion Karabolli

Kisha nevojë të pushoja, kështu që, mora me qira një shtëpi të madhe në një fshat të bregut, larg qytetit. Shtëpia ishte pesëmbëdhjetë kilometra nga fshati, nëpër rrugën e pashtruar, në drejtim të detit. Kur po i afrohesha, barishtet e gjata nuk më lejuan të vazhdoja me makinë. Çatia e shtëpisë dukej së largu. Mora guximin të zbrisja. Mora me vete gjërat e domosdoshme dhe vazhdova në këmbë. Po errej dhe, ndonëse deti nuk dukej, mund t'i dëgjoja dallgët tek përplaseshin në breg. Isha vetëm pak metra larg shtëpisë, kur u përplasa me diçka.

- Jeni ju?

U zmbrapsa i trembur.

- Jeni ju, zotëri? - një burrë u ngrit në këmbë me vështirësi. - As edhe një ditë të vetme nuk e kam çuar dëm, hë... Ju betohem për shpirt të nënës...

Fliste me ngut; shtriu zhubrat e teshave dhe rregulloi flokët.

- Puna është se pikërisht mbrëmë... Merreni me mend, zotëri, nuk do t'i shtyja punët për ditë tjetër, duke qenë se duhet edhe kaq pak. Ejani, ejani, - tha dhe u fut në një pus, që ishte mes barishteve, vetëm një hap nga ku gjendeshim ne.

U përkula dhe zgjata kokën. Gropa ishte më shumë se një metër e gjerë dhe brenda nuk shihej dot asgjë. Për kë mund të punonte një çirak që s'ishte i aftë të njihte as kryemjeshtrin e vet? Çfarë mund të kërkonte duke rrëmihur aq thellë?

- Zotëri, nuk do të futeni?

- Më duket se po më ngatërroni, - i thashë.

- Çfarë?

I thashë se nuk do të futesha dhe, meqenëse nuk m'u përgjigj, u nisa për në shtëpi. Vetëm kur mbërrita te shkallët e hyrjes, dëgjova së largu: "shumë mirë, zotëri, si të dëshironi ju".

Të nesërmen në mëngjes, dola të shkoja për të marr gjërat që kisha lënë në makinë. I ulur te portiku i shtëpisë, burri kishte varur kokën, i këputur për gjumë, dhe mbante një lopatë të ndryshkur, mes këmbëve. Me të më parë, e la lopatën dhe nxitoi të më arrinte. I ngarkoi në krahë gjërat më të rënda dhe, duke më treguar me shenjë ca pako, më pyeti nëse ato ishin pjesë e planit.

- Së pari, duhet të sistemohem, - thashë dhe, kur mbërritëm te porta, ia mora gjërat që mbante ngarkuar, me qëllim që të mos hynte brenda.

- Po, po, zotëri. Si të urdhëroni ju.

Hyra brenda. Këqyra plazhin nga dritarja e kuzhinës. Pothuajse nuk kishte fare dallgë, ishte një det ideal për të bërë not. Përshkova kuzhinën dhe përgjova nga dritarja ballore: burri vazhdonte aty. Herë-herë vështronte pusin dhe herë-herë kundronte qiellin. Kur dola, e ndryshoi pozicionin dhe më përshëndeti me respekt.

- Çfarë do të bëjmë, zotëri?

Kuptova se do të mjaftonte thjesht një gjest imi, që burri të turrej me vrap drejt pusit dhe të fillonte gërmimin. Ia hodha sytë lëndinës barishtake, andej nga ishte pusi.

- Si thoni ju, edhe sa duhet që të mbarojë?

- Edhe pak, zotëri, shumë pak...

- Sa është pak për ju?

- Pak... nuk jua them dot me saktësi.

- Besoni se mund ta mbaroni sonte?

- Nuk ju siguroj dot gjë... ju e dini: kjo punë nuk varet vetëm nga unë.

- Epo, mirë, meqë e paskeni me kaq dëshirë të madhe, bëjeni.

- Si urdhëroni, quheni të kryer, zotëri.

Pashë se si burri e mori lopatën, zbriti shkallët e shtëpisë, eci deri te lëndina barishtake dhe u zhduk brenda pusit.

Më vonë, shkova në fshat. Ishte një paradite me diell dhe doja të blija një palë rroba banje, për të shijuar detin; tekefundit, nuk kisha pse të shqetësohesha për një burrë që hapte një gropë në një shtëpi që s'ishte imja. Hyra në shitoren e vetme që gjeta hapur. Teksa mbështillte blerjen time, shitësi më pyeti:

- Si po shkon rrëmihësi juaj?

Qëndrova në heshtje për disa çaste, ndoshta po prisja që të përgjigjej dikush tjetër.

- Rrëmihësi im?

Më zgjati qesen.

- Po, rrëmihësi juaj...

I zgjata paratë dhe e këqyra i habitur; para se të ikja nuk munda dot të mos e pyesja:

- Nga e dini ju punën e rrëmihësit?

- Nga e di unë punën e rrëmihësit? - tha, sikur të mos më kuptonte.

U ktheva në shtëpi dhe rrëmihësi, i cili po priste i fjetur në portik, u zgjua menjëherë sapo hapa portën.

- Zotëri, - tha, duke u ngritur në këmbë, - puna ka ecur goxha, ka gjasa që të jemi çdo herë e më pranë...

- Kam ndër mend të shkoj në plazh, para se të erret.

Nuk e mbaj mend pse m'u duk ide e mirë që t'ia thosha këtë. Por, ja tek qëndronte ai, i lumtur nga fjalët e mia dhe i gatshëm që të më shoqëronte. Më priti jashtë derisa u ndërrova dhe, pak minuta më pas, po ecnim të dy bashkë drejt detit.

- Nuk prish punë që ta lini pusin? - e pyeta.

Rrëmihësi u ndal.

- Doni që të kthehem?

- Jo, jo, thjesht po ju pyes.

- Puna është se, po ndodhi ndonjë gjë... - u bë gati

të kthehej, - do të ishte e tmerrshme, zotëri.

- E tmerrshme? E çfarë mund të ndodhë?

- Duhet të vazhdoj gërmimin.

- E pse?

Ai vështroi qiellin dhe nuk ktheu përgjigje.

- Nejse, mos u shqetësoni, - thashë dhe vazhdova të ecja, - ejani me mua.

Rrëmihësi më ndoqi prapa, i ndërdymë.

Kur arritëm në plazh, pak metra larg detit, u ula për të hequr këpucët dhe çorapet. Burri u ul krah meje, e la mënjanë lopatën dhe hoqi çizmet.

- A dini not? - e pyeta. - Pse nuk futeni me mua në det?

- Jo, zotëri. Unë thjesht do t'ju shoh, nëse më lejoni. E solla lopatën me vete, nëse ju shkon ndër mend ndonjë plan tjetër.

U ngrita në këmbë dhe eca drejt detit. Uji ishte i ftohtë, por e dija që burri po më vështronte dhe nuk doja të bëja prapakthehu.

Kur dola nga deti dhe u ktheva, rrëmihësi nuk ishte më aty.

Me një ndjesi gjëme, pashë për ndonjë gjurmë të mundshme në drejtim të ujit, se mos, mbase, kishte ndjekur kështillën time dhe ishte zhytur, por nuk gjeta asgjë dhe atëherë vendosa të kthehesha për në shtëpi. Kontrollova pusin dhe rrethinat afër. Në shtëpi, i brodha dhomat me mosbesim. Qëndrova në sheshpushimin e shkallëve, e thirra me zë të lartë nëpër korridore, paksa i turpëruar. Më pas, dola jashtë. Shkova deri te pusi, zgjata kokën mbi të dhe e thirra përsëri. Brenda pusit nuk shihej asgjë. U shtriva barkas përdhé, futa dorën brenda dhe preka muret e pusit: ishte bërë një punë shumë e rregullt, një pus me diametër pak a shumë një metër, që thellohej drejt qendrës së tokës. E çova në mendje mundësinë që të futesha brenda, por aty për aty e hodha poshtë. Kur e mbështeta njërën dorë për t'u ngritur, zgripet e pusit u thyen e shkanë. U mbërtheva për barishtet dhe, i paralizuar, dëgjova zhurmën e dheut që binte në terr. Gjunjët e mi rrëshqitën deri te buza dhe këqyra se si gryka e pusit shembej dhe humbiste në thellësi të tij. U ngrita në këmbë dhe vështrova katastrofën. Këqyra me frikë rreth e rrotull, por rrëmihësi nuk dukej asgjëkund. Atëherë më lindi mendimi se mund ta ndreqja me pak dhé të lagësht buzën e pusit, ndonëse për këtë punë më duhej një lopatë dhe pak ujë.

U ktheva në shtëpi. Hapa dollapët, kontrollova dy dhoma në pjesën e prapme, te të cilat hyra për herë të parë, kërkova te depoja. Më në fund, në një kuti, pranë ca veglave të tjera të vjetra, gjeta një lopatë kopshti. Ishte e vogël, por gjithsesi bënte punë. Kur dola nga shtëpia, u ndesha ballë për ballë me rrëmihësin. E fsheha lopatën prapa trupit.

- Po ju kërkoja, zotëri. Na ka dalë një problem.

Për herë të parë, rrëmihësi po më shikonte me mosbesim.

- Më thoni, - thashë unë.

- Dikush tjetër ka gërmuar.

- Dikush tjetër? Jeni i sigurt?

- Unë e njoh punën time. Dikush ka gërmuar.

- Po ju, ku ishit?

- Po mprehja lopatën.

- Nejse, - thashë, duke u munduar të tregohesha i prerë, - ju vazhdoni të gërmoni sa të keni mundësi dhe mos u hallakatni më. Unë do të kontrolloj rreth e rrotull.

U ndërdym. U largua disa hapa, por më në fund u ndal dhe u kthye nga unë. I pavëmendshëm, unë e kisha ulur dorën dhe lopata varej pranë këmbëve të mia.

- Keni ndër mend të gërmoni, zotëri? - më këqyri.

Vetvetiu e fsheha lopatën. Në sytë e tij, dukej se unë nuk isha më njeriu që kisha qenë për të deri para një çasti.

- Keni ndër mend të gërmoni? - këmbënguli.

- Do t'ju ndihmoj. Gërmoni ju një copë herë dhe, kur të lodheni, vazhdoj unë.

- Ju s'mund të gërmoni, - tha, - kjo është gropa juaj.

Rrëmihësi ngriti lopatën dhe, duke më vështruar në sy, e nguli sërish në tokë.

ExLibris
BASHKIM SHEHU:
NË SHKRIMET E MIA
JANË PËRFSHIRË
ELEMENTE TË JETËS
SUAJ PO AO SA TË
JETËS SIME
ARISTOTEL SPIRO:
NUHJA SHKENCORE E
GREQËSHTES MË NDIHMON TË
JEP JA KONTRIBUTIN TIM MODEST
NË GJUHËN SHQIPE
DHE KULTURËN SHQIPTARE...
BIBLIOTEKA
ODISEJA E NË
TAKIMA NË
KOHAPSHE